



DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / www.dritaislame.al

Viti XXXV / Nr. 03 / Mars 2026

VAZHDIMËSI
edhe pas Ramazanit



“DRITA ISLAME”

**Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë**

www.dritaislame.al

DREJTOR

Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR

Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA

Erzen Carja

KONTAKT:

Tel/fax +355 68 87 71 655

E-mail: mehmet.disha@kmsh.al


Viti XXXV i botimit

Nr. 03 (513)


Mars, 2026

ISSN 2226-7115

*Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen, nuk
paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.*



www.dritaislame.al



editorial

04 Vazhdimësi edhe pas Ramazanit
Dorian Demetja

në fokus

06 Metafizika në shkencat humane
Prof. Dr. Ajhan Tekinesh

lajme / aktivitete

08 01-Zhvillohet aktiviteti për mbledhjen e fondeve për xhaminë e Parmës, Itali
02-Zhvillohet ceremonia hapëse e shportës së Ramazanit
03-KMSH shtron iftarin e parë të këtij Ramazani
04-Mirë se vjen Ramazan
05-KMSH dërgon pako ushqimore tek familjet në Gaza
06-35 Vite nga rihapja e xhamisë "Kokonozi"

refleksione

14 Morali i heshtur i krijimit
Zekerija Çiçek

çështje fetare

16 A lejohet që paratë që kam dhënë borxh t'i quaj zekat?
Këshilli për Çështjet Fetare - insi.al

familja

18 Familja, themeli bazë i bashkësisë njerëzore
Aida Kurti

horizonti i besimit

22 Të jetosh mes njerëzve duke qenë me të vërtetin
Tauland Bica

24 Myslimanët, të parët që denoncuan komunizmin
Genti Kruja

26 Feja midis filozofisë së jetës dhe dogmës
Leonard Çela

28 Islami dhe diversiteti njerëzor
Jonida Cekaj

bota shpirtërore


32 Një lutje nga Uveys el'Karani
Redaksia

hapësirë fëminore

36 Pëllumbat e shpellës
Hapësire Fëminore

këndi i poezisë

38 Ç'do të bëhet, vallë, halli im!
Junus Emre



VAZHDIMËSI

edhe pas Ramazanit

“Gjithçka që është në tokë është kalimtare, mbetet vetëm Zoti yt, i Lartë dhe Fisnik” (Rahman, 26-27).

Shkoj edhe muaji më i dashur dhe miku më i njohur ndër myslimanët, Ramazani, muaji i agjërimit, mëshirës, lutjeve; muaji i shpalljes së Kuranit, muaji në të cilin nuk u kursye ndihma dhe favori hyjnor.

A nuk ishe në mesin tonë deri para disa momenteve? A nuk ishe gjallërim e zbukurim i jetës dhe xhamive tona? I vizitonim të afërmit dhe miqtë, përgatitnim iftare, kërkonim falje për mëkatet, bënim lutje, adhurim... Në gjithçka ndihej një gëzim i fshehtë, në shtëpi, në njerëz, në rrugë, në natyrë. E ku është tani?

Ah sa mysafir i mirë dhe i vërtetë! Asnjë vit, nuk na harron.

Na mundësive o Ramazan që një e mirë e jona në këtë muaj, të jetë e barabartë me një obligim në muajt e tjerë dhe një obligim të jetë shtatëdhjetë herë më i vlefshëm se i njëjti në muajt e tjerë. Na mundësive që frymëmarrja jonë të jetë lavdi dhe fjetja lutje.

Na mundësive që të njihemi më gjerësisht me Kurantin dhe na tregove se në fjalë askush nuk mund të jetë më i saktë se Allahu. Na njoftove se Kurani është burimi i

diturisë dhe udhëzues për çdo njeri.

Ti shkove duke zbatuar ligjin e Zotit, e për përshëndetje të fundit po na lë festën e Bajramit, por a thua i ke pranuar lutjet, faljet e namazeve, agjërimin, pendimet, të mirat dhe bisedat tona?! Megjithatë, dyert për pendim i ke lënë të hapura, duke na treguar se si thotë Allahu (xh.sh.) në Kuran:

“O robërit e Mi, që e keni ngarkuar veten tuaj me mëkate, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut, pse vërtetë Allahu i falë të gjitha mëkatet. Ai është që falë shumë dhe i mëshirshëm”. (Zumer, 39:53)

Edhe për ne, shqiptarët, ishe i mirëseardhur sepse na ofrove durim, bekim, pastërti e njohuri të pafund. Na bëre me dije se në Kuran është dituria, mençuria, pasuria e pafund dhe e vërteta absolute. Na tregove se ai është shërues shpirtëror, trupor dhe nervor i njeriut.

Ishe prej atyre që së pari i ftove ata të agjërojnë, të mbjellin virtytin e dashurisë dhe të largojnë nga zemrat e tyre ligësinë, zilinë, smirën, hidhërimin, inatin, gjaknxehësinë, etj. Pastaj i ftove që të bëhen dinjitarë, të sinqertë, të butë, të mëshirshëm, të pastër, duke na bërë të heqim dorë nga punët e ndaluara. Na mësove të duam



njëri-tjetrin për Allahun (xh.sh.) dhe na bëre të kuptojmë më thellë vëllazërimin në Islam.

Krahas popujve të tjerë edhe ne shqiptarët kemi nevojë për prehje shpirtërore, për pastrim shpirtëror, për qëndrueshmëri, durim, mbisundim të egos, për çlirim nga kultura e huaj, për stabilitet, drejtësi, barazi e marrëdhënie të mira të mbështetura në parimet e Ramazanit.

Drejtimin që morëm në Ramazan, suksesin e sjelljeve dhe jetën e përparuar fetare që arritëm, është e nevojshme t'i vazhdojmë më tej. Kështu pra, duke i dhënë lamtumirën Ramazanit, është shumë gabim që t'u japim lamtumirën edhe xhamisë, adhurimit dhe portës së Allahut. Me begatinë dhe vrullin që morëm nga ky muaj i bekuar, ndërsa çdo ditë këpusim nga një fletë prej kalendarit tonë dhe largohemi prej botës së vdekshme, duhet që, duke u lartësuar shpirtërisht, të përgatitemi për t'iu afruar edhe pak më shumë Allahut, për të arritur tek Ai, për të dalë në audiencë para Tij! Po qe se ditët tona do t'i kemi të njëjta me njëra-tjetrën, po të mos përparojmë çdo ditë sadopak në jetën fetare, do të thotë se gënjejmë veten. Duhet medoemos që çdo ditë të përparojmë vijimisht drejt

përjetësisë, në raport me të shkuarën duhet të jemi më të përgatitur e më të fuqishëm.

Mbetet të themi se Allahu nuk është nevojtar për adhurimin e askujt. Adhurimet, lufta me nefsin, egon dhe armiqtë tanë të tjerë, janë për ne, për formimin tonë dhe për jetën tjetër që është perspektiva e përjetshme! Nuk ka rrugë tjetër për t'u formuar dhe për t'iu afruar Allahut. Fjalë të tilla si "unë nuk falem, nuk jam fetar, por zemrën e kam të pastër", janë fjalë boshe që s'shprehin asgjë, madje edhe ai vetë nuk i beson. E vetmja rrugë e drejtë që të çon te Zoti, është "të besosh" dhe "të vepros". Të tjerat që mbeten janë dredhi e djallit, gënjeshtër e egos...

Tashmë po dalim nga muaji i bekuar i Ramazanit me fuqi, energji dhe vullnet të akumuluar për gjatë gjithë vitit vijues. Jemi më të bindur dhe e ndjejmë veten më të përgatitur shpirtërisht, moralisht të mobilizuar dhe të gatshëm për Ramazanin tjetër.

Së fundi e lusim Allahun të na i pranojë të tëra adhurimet që i kemi bërë gjatë këtij muaji; agjërimin, lutjet, faljet e namazeve, leximin e dëgjimin e Kuranit, sadaka-i fitrin dhe të gjitha veprat e tjera të mira.

METAFIZIKA NË SHKENCAT HUMANE



Ne besojmë se Metafizika është një realitet universal ashtu si edhe shkencat. Shkëputja midis shkencave ekzakte dhe fesë është një temë mbi të cilën janë bërë shumë diskutime. Njëra prej këtyre shkëputjeve është ajo midis njeriut plus shkencave shoqërore dhe, në përgjithësi metafizika, në veçanti fesë. E pikërisht, unë jam i mendimit që kjo shkëputje tregon ndikime më të mëdha. Shkencat ekzakte, prej nga mes i shekullit të IX, e kanë shtuar jashtë mase ndikimin e tyre në botën e dijes dhe duke u ndihmuar edhe nga fuqia e pashmangshme e zhvillimeve teknologjike, arriti të bëhej burimi më ndikues i dijes, duke marrë kështu nën ndikimin e tyre edhe fusha të tjera si filozofinë, artin, letërsinë, etikën dhe fenë.

Metoda empirike, në të cilën bazohen shkencat ekzakte, ka ndikuar edhe shkencat shoqërore. Ndikimi i shkencave humane, kryesisht të filozofisë dhe fesë, përgjatë gjithë historisë ndaj shkencave

ekzakte në këndvështrim të termave, metodave dhe përmbajtjes; duke u nisur nga shek. i IX, ka ndryshuar drejtim. Metoda e shkencave ekzakte e bazuar në materie, me një dimension dhe përjashtues së metafizikës, ka bërë një ndikim negativ mbi shkencat humane dhe ka penguar zhvillimin e tyre. Disa mendimtarë, të cilët i dalluan këto ndikime negative, duke mbrojtur tezën që metoda e shkencave humane është e bazuara në boshtin e të kuptuarit, propozuan idenë me dy fusha dhe dy metoda të ndryshme.

Kurse disa mendimtarë të tjerë, të cilët arritën të dallojnë që ndarja midis shkencave çonte vetëm në verbërinë e disiplinave dhe vështirësonte kuptimin e të vërtetës në universalitetin e saj, duke promovuar studimet multidisiplinare, mbrojnë tezën se kufijtë midis shkencave duhen mbajtur pak më elastike.

Këndvështrimi i disa shkencëtarëve ndaj njeriut si një objekt mbi të cilin bëhen eksperimente, pa

marrë parasysh vlerat morale universale, e kanë shtuar akoma më tepër largësinë midis shkencës dhe moralit. Si rezultat i kësaj, botëkuptimi i dijes së zbrazët nga vlerat dhe parimet morale, kanë bërë të mundur shfaqjen e shumë problemeve të reja. Probleme, të cilat sollën në diskutim çështjen që dimensionin moral i shkencës nuk duhet të neglizhohet. Kështu, me dëshirën për të mbyllur hapësirat midis mendimit shkencor dhe gjykimeve të vlerave morale, u promovuan studimet në fushën e etikës shkencore dhe profesionale. Veç kësaj, duke pranuar që shkencat e sjelljes dhe ato të edukimit ishin të mjaftueshme për të treguar dhe mësuar të drejtën, dolën në dritë shumë mundime në mënyrë që të kompensohej pjesërisht mangësia ndaj vlerave morale.

Sipas mendimit tim personal, pas të gjitha këtyre problemeve bashkëkohore dhe konflikteve historike midis shkencës dhe filozofisë-fesë, qëndron pranimi i ideve të të dyja fushave si të vërteta të padiskutueshme. Siç është i papranueshëm dominimi i njerëzve fetarë mbi shkencën në periudhat kur feja ishte e fuqishme dhe aktive, po ashtu i papranueshëm është edhe përjashtimi nga fusha e shkencës dhe mendimeve, që i bëri shkencën spiritualizmit me kalimin e autoritetit në duart e saj.

Gjithësia, njeriu dhe jeta duhet të nënkuptohen si një e vetme. Sepse tashmë është një e vërtetë e qartë që pjesëzat më të vogla përbërëse të lëndëve pa jetë nuk kanë asnjë dallim nga pjesëzat më të vogla përbërëse të trupit të njeriut, ose që trupat qiellorë që na rrethojnë neve dhe lëndët e tjera pa shpirt, janë të njëjtë. Domethënë: ligjet e gjithësisë, veprojnë në formë gjithpërfshirëse, të përgjithshme dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Atëherë, njeriun dhe jetën nuk duhet ta konceptojmë si një fushë të qenieve të veçanta e të pavarura nga bota fizike.

Siç nuk është e mundur t'i mendojmë shkencat natyrore të ndara nga fusha e fesë, po ashtu është e pamundur t'i mendojmë shkencat natyrore dhe shkencat humane të pavarura nga njëra-tjetra. Duket qartë që veçoria që e dallon njeriun nga qeniet e tjera është mendja, shpirti dhe vullneti. Kultura dhe qytetërimi që ka formuar njeriu brenda këtyre dallimeve që ai posedon duhet të jetë në harmoni me rregullsinë që ndodhet në gjithësi. Vetëm se, njeriu modern këto dallime i përdor si një shkasë për sundim dhe mundohet që çdo gjë ta ulë në nivelin e perceptimeve të tij. Ai mundohet që pesë shqisat ndijore dhe aftësitë e intelektit të tij t'i

kthejë në të vetmet kritere për të perceptuar dijen e vërtetë.

Shqisat tona të jashtme perceptojnë vetëm atë çka shohin, kurse intelektin mundohet që të kuptojë të vërtetën duke logjikuar dhe klasifikuar informacionet. Klasifikimi, është një nga aftësitë që njeriu posedon dhe që intelektin i tij e ka të nevojshme ta përdorë për të kuptuar ndodhitë e për të shpjeguar gjithësinë. Kjo aftësi megjithëse nga njëra anë na lehtëson shpjegimin e së vërtetës duke e copëzuar atë dhe gjithashtu na ndihmon të kuptojmë disa drejtime të veçanta të saj, nga ana tjetër, mund të vlerësohet edhe si njëra nga dobësitë kryesore të njeriut. Një aftësi tjetër shumë e rëndësishme veç intelektit është ndërgjegjja. Ndërgjegjja është më e predispozuar për ta kuptuar të vërtetën si një e tërë. Sepse ajo, mund të na sigurojë që e vërteta të kuptohet si një e tërë, së bashku me ndihmën e aftësive të tjera, të cilat hapen në thellësitë e ndjenjës, unit, vullnetit dhe shpirtit të njeriut.

Njeriu, ka për ta arritur unitetin në brendësinë e tij vetëm kur të vërë në punë aftësitë shpirtërore dhe të dëgjojë zërin e zemrës e të shpirtit të tij. Është e pamundur të eliminojmë dualizmin e të perceptuarit të botës së jashtme pa arritur unitetin brenda nesh. Sepse njeriu botën e jashtme dhe të tjerët, i vështron nga dritarja e tij e brendshme. Njeriu i zemëruar e sheh çdo gjë të veshur me këtë ndjeje. Po ashtu, edhe njeriu, i cili është kapur fort pas perceptimeve të pesë shqisave dhe që intelektin e ndjesitë e tij të jashtme i ka pranuar si kritere të vetëm të të vërtetës e ka shumë të vështirë të dallojë anën shpirtërore të jetës dhe gjithësisë.

Shpresoj që trajtimi i njeriut së bashku me ndjenjat, mendimet, moralin dhe ndërgjegjen, ka për ta shtuar ndikimin e shkencave humane mbi njeriun dhe shoqërinë. Si rezultat ka për të shtuar edhe reputacionin e këtyre shkencave të vjera. Veç kësaj, vlerësimi e interpretimi i shkencave humane dhe shkencave natyrore në kuadrin e parimeve metafizike universale, të cilat janë të hapura ndaj risive, ka për t'ia dhuruar edhe njëherë perceptimit tonë të shkencës mendimin e qëllimit. Në këtë mënyrë edhe shkencat sociale, në vend që të përdoren si mjete për të nxjerrë konflikte, duke u riformuar në kornizën e vlerave të përbashkëta humane dhe parimeve morale, të cilat i kushtojnë rëndësi besimeve dhe botëkuptimeve të ndryshme, do të japin kontributin e tyre në formimin e paqes botërore, dialogut ndërkulturor dhe harmonisë shoqërore.

01 ZHVILLOHET AKTIVITETI PËR MBLEDHJEN E FONDEVE PËR XHAMINË E PARMËS, ITALI



Çaste nga mbrëmja e ngrohtë vëllazërore që patëm privilegjin ta ndajmë së bashku me bashkatdhetarët tanë në Parma të Italisë, ku u zhvillua një program fetar me hoxhallarë të mirënjohur nga Shqipëria dhe diaspora, si dhe me përfaqësues të pushtetit vendor të Parmës.

Kjo mbrëmje u organizua me një qëllim të përbashkët dhe fisnik: mbledhjen e fondeve të nevojshme për blerjen e truallit dhe hedhjen e hapave të parë drejt ndërtimit të xhamisë dhe qendrës kulturore në Parma, si një vatër besimi, kulture dhe bashkëjetese për komunitetin tonë në shtetin fqinj.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë falenderon të gjithë ata që kontribuan gjatë kësaj mbrëmjeje. Allahu (xh.sh.) ju shpërbleftë me të mirat e Tij të pafundme, si në këtë botë ashtu edhe në ahiret!



02 ZHVILLOHET CEREMONIA HAPËSE E SHPORTËS SË RAMAZANIT



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Qendrën Barmirëse dhe Humanitare “Mbreti Selman” dhe me koordinimin e Ambasadës së Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, çelën sot në ambientet e Kolegjit Universitar “Bedër”, fushatën e përvitshme të barmirësisë në ndihmë të 6500 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Të pranishëm në ceremoninë e inaugurimit të kësaj fushate, ishin: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Bujar Spahiu, Ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi, Përfaqësuesi i Qendrës Humanitare “Mbreti Selman”, z. Sulejman el-Rebdi, nënkryetari i KMSH, z. Lauren Luli, Myftiu i Tiranës, z. Gazment Teqja, Drejtori i Marrëdhënieve me Besimtarët në KMSH, z. Shpëtim Seranaj, si dhe imamë e familjarë të ndryshëm.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, falënderoi përfaqësuesit e qendrës “Mbreti Selman” dhe Ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, të cilët, për të 10-tin vit radhazi po bëjnë të mundur aplikimin e këtij projekti mjaft të rëndësishëm për familjet në nevojë përgjatë muajit të begatë të Ramazanit.

Ndërsa z. Fajsal Gazi Hifdhi, ambasador i Mbretërisë së Arabisë Saudite në vendin tonë theksoi gjatë fjalës së tij marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve tona dhe përforsimin e tyre të vazhdueshëm nëpërmjet nismave të tilla. Fillimisht pakot me nga 45 kg ushqime secila, do t’ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së nëpër 36 myftinitë e vendit, më pas, këta të fundit do t’jua shpërndajnë familjeve në nevojë.



03 KMSH SHTRON IFTARIN E PARË TË KËTIJ RAMAZANI



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, shtroi iftarin e parë, ku morën pjesë: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj, kryetarë të komuniteteve fetare të vendit, ministra, deputetë, personalitete publike, ambasadorë, gazetarë, zyrtarë qendror e lokal, myftinj, imamë si dhe besimtarë të shumtë.

Në fjalën e tij të rastit, Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe ju uroi agjërim të lehtë e të pranuar tek Allahu (xh.sh) të gjithë besimtarëve, theksoi se Ramazani nuk është vetëm një praktikë personale adhurimi, por një projekt etik dhe moral që synon formësimin e karakterit, forcimin e ndërgjegjes dhe ripërtëritjen shpirtërore e atë sociale.

Në përmbyllje, ai bëri thirrje për drejtësi, dialog, solidaritet dhe vendimmarrje të bazuar në parime, duke uruar që Ramazani të shërbejë si kohë reflektimi dhe bekimi për vendin dhe shoqërinë tonë.

Të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Begaj, i cili u shpreh se me nisjen e iftarit të parë troket në vatrën tona një muaji i begatë, i cili për çdo besimtar mysliman shënon një rrugëtim të ri shpirtëror.

Më tej, të pranishmit konsumuan iftarin e parë të këtij muaji të bekuar.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, uron të gjithë besimtarët Gëzuar Muajin e Bekuar të Ramazanit!



04 MIRË SE VJEN RAMAZAN



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Medresenë e Tiranës, zhvilloi ditën e sotme në ambientet e Universitetit të Arteve programin artistiko-fetar me titull "Mirë se vjen Ramazan".


Të pranishëm në këtë aktivitet, ishin: Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari i institucionit, z. Taulant Bica, Drejtori i Arsimit në KMSH, z. Elton Karaj, Dr. Sari Fusha, Drejtori i Medresesë së Tiranës, z. Ardit Dragoti, si dhe drejtues institucionesh, personalitete të fushave të ndryshme, familjarë dhe një numër i madh nxënësish e studentësh.

Programi u çel me leximin e disa ajeteve Kuranore nga z. Armend Beqiri.

Më pas, në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu u ndal te domethënia e vërtetë e Ramazanit, duke theksuar se ky muaj nuk është thjesht përmbajtje fizike nga ushqimi dhe pija, por një proces i thellë vetëpastrimi dhe ndërgjegjësimi shpirtëror.

Në vijim, Dr. Sari Fusha referoi mbi dobitë shëndetësore të agjërit, duke evidentuar ndikimin pozitiv që ai ka në organizëm, në sistemin metabolik dhe në mirëqenien psikologjike të njeriut, si një praktikë që harmonizon dimensionin shpirtëror me atë fizik.

Mbrëmja vijoi më tej me interpretime të ndryshme artistike dhe ilahi të interpretuara nga Merita Burrniku dhe Armend Beqiri, të cilët përcollën emocione të veçanta tek të pranishmit. Një moment kulmor i programit ishte interpretimi për herë të parë i poezisë "Hana e Ramazanit", shkruar nga Ferit Vokopola, e sjellë në skenë nga aktori i mirënjohur Dritan Boriçi.



05 KMSH DËRGON PAKO USHQIMORE TEK FAMILJET NË GAZA



Dhjetëra pako me ushqime bazë janë shpërndarë për familjet në Gaza, të cilat vijnë të përballen me sfida të rënda humanitare si pasojë e luftës. Këto ndihma u realizuan në këtë muaj të bekuar të Ramazanit, duke sjellë lehtësim dhe shpresë për shumë familje në nevojë.

Shpërndarja në terren u bë e mundur falë bashkëpunimit me Shoqatën "Mirësi për Botën", e cila garantoj që ndihmat të mbërrijnë drejtpërdrejt te përfutuesit.

Këto pako ushqimore u siguruan nga donacione të ndryshme të dhuruara në KMSH me destinacion Gazën, si dhe nga të ardhurat e mbledhura në nëntor të vitit që lamë pas, kur Zyra e Gruas pranë KMSH-së zhvilloi një panair bamirësie në kuadër të festave të nëntorit.

Panairi mbledhi së bashku besimtarë dhe qytetarë të shumtë, të cilët kontribuan përmes blerjes së produkteve të ofruara, duke u bërë shkak që të gëzojnë dhjetëra familje gjatë muajit të bekuar të Ramazanit.

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë shpreh mirënjohje për të gjithë kontribuesit që u bënë pjesë e kësaj nisme fisnike, si dhe vlerëson përkushtimin e Shoqatës "Mirësi për Botën" në ndjekjen dhe realizimin me sukses të shpërndarjes së ndihmave në terren.



06 35 VITE NGA RIHAPJA E XHAMISË "KOKONOZI"



Në ambientet e xhamisë së Kokonozit u zhvillua programi përkujtimor me rastin e 35-vjetorit të rihapjes së saj, një moment i rëndësishëm që solli në vëmendje historinë, rolin dhe kontributin e kësaj xhamie ndër vite.

Aktiviteti u çel me fjalën përshëndetëse të nënkryetarit të Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, z. Lauren Luli, i cili theksoi rëndësinë e lirisë së besimit dhe rrugëtimin e suksesshëm të xhamisë që nga rihapja e saj në vitin 1991 e deri më sot.

Më pas, Myftiu i Tiranës, z. Gazment Teqja, vuri në dukje rolin thelbësor të xhamive në jetën shpirtërore, sociale dhe morale të besimtarëve, si dhe ndikimin pozitiv të tyre në shoqëri.

Fjalë rasti mbajtën gjithashtu z. Bledar Komini dhe z. Dorian Demetja, të cilët ndaluan në historikun e Xhamisë së Kokonozit dhe të medresesë së saj, duke sjellë në vëmendje kontributet dhe sfidat ndër vite.

Programi vijoi me përshëndetjet e ish-imamit të xhamisë, z. Saimir Ismaili, dhe ish-vaizit, z. Nasuf Hoxha, të cilët ndanë me të pranishmit kujtime dhe përjetime nga shërbimi i tyre në këtë xhami.

Në përmbyllje, imami i xhamisë, z. Erjol Haxhiu, së bashku me nënkryetarin Luli dhe Myftiun e Tiranës, z. Teqja, vlerësuan me certifikata mirënjohjeje disa prej kontribuesve më të spikatur ndër vite për përkushtimin dhe rolin e tyre në zhvillimin dhe ecurinë e xhamisë.

Allahu i begatoftë xhamitë tona dhe i bëftë ato burim drite, paqeje dhe udhëzimi për besimtarët!



MORALI I HESHTUR I KRIJIMIT



Një univers i koduar me bashkëpunim

Jeta në tokë, në çdo nivel të saj, nuk është kaos, por rend. Çdo mëngjes zogjtë këndojnë në të njëjtën orë; fluturat përshkojnë mijëra kilometra duke ndjekur të njëjtën rrugë; pemët, me një ritëm të padukshëm, japin fryte në çdo stinë. Në dukje, kjo është thjesht një harmoni fizike, por në thelb ajo fsheh një pasqyrim të moralit hyjnor, një urtësi të ngjizur me mëshirë: bashkëpunimin.

Në gjuhën e biologjisë, kjo quhet marrëdhënie simbiotike: mënyra se si qeniet e gjalla jetojnë së bashku pa i bërë dëm njëra-tjetrës, duke përfituar në mënyrë të ndërsjellë ose edhe vetëm nga njëra anë. Këto marrëdhënie ndonjëherë ndodhin midis llojeve të ndryshme, e ndonjëherë brenda të njëjtës specie. Por ajo që të mahnit është se asgjë në këtë ndërveprim nuk është rastësi, çdo gjë ndodh me dije të përsosur, me ritëm të saktë, me vazhdueshmëri të rregullt, në një plan të harmonizuar dhe me ekuilibër të hollë.

Ky rend i padukshëm për syrin e shkujdesur, përshkruhet në mënyrë madhështore në Kur'anin Famëlartë: **"Ai është që lëshon ujë nga qielli, dhe me të ne nxjerrim çdo lloj bime. Prej saj dalin filiza, e prej filizave tufa kokrrash të mbivendosura. Nga lulet e hurmës varen degë me fruta, dhe nga to rriten kopshte me rrush, ullinj e shegë - disa të ngjashme, e disa të ndryshme. Shikoni frutat e tyre, kur fillojnë e kur piquen! Me të vërtetë, në këto ka shumë mësim për ata që besojnë."** (En'am, 6/99)

Në të njëjtën frymë, Bediuzzaman Said Nursiu vëren: "Rendi dhe ndihmesa që shfaqet në këtë univers dëshmon se çdo gjë është bërë me urtësi; asgjë nuk është e lënë pas dore apo pa qëllim."¹ Dhe kështu mbetet pyetja thelbësore: Pse qenie të ndryshme, madje edhe organizma që s'e njohin njëri-tjetrin, ndihmojnë njëri-tjetrin? Si ndodh që këto "sjellje të mira", ky moral i bashkëpunimit, përsëriten në çdo brez, në çdo skaj të botës, si një ligj universal i jetës? Vetëm kur shohim disa prej këtyre bashkëveprimeve konkrete, fillojmë të kuptojmë madhështinë e këtij rendi të heshtur që përshkon krijimin.

Rrjeti misterioz nën Tokë: Shpërndarja e ushqimit dhe informacionit midis pemëve

Studimet e fundit në Universitetin e Vankuverit² tregojnë se nën rrënjët e pemëve shtrihet një rrjet kërpudhash, pothuaj si një "internet natyror", që mundëson komunikimin mes pemëve. Përmes këtij sistemi, pemët e vjetra ndajnë sheqer dhe ujë me të rejat, ndërsa pemëve të sëmura u ofrohet mbështetje. "Komunikim i ndërgjegjshëm dhe bashkëpunim midis bimëve pa arsyetim dhe vetëdije?!" Si mund të shpjegohet kjo rrjetë e përsosur pa i atribuar atë një Krijuesi të mençur? Ky shkëmbim informacioni nuk

1. Said Nursi, B. (2009): Şualar, Âyetü'l-Kübrâ, R.N.K. Şahdamar Yayınları, fq. 123-220. Üsküdar, İstanbul.

2. Simard, S. (2021): Finding the Mother Tree: Discovering the Wisdom of the Forest, Knopf Canada.

ndodh rastësisht; ai zhvillohet brenda një sistemi të rregullt dhe të qëllimshëm.

Në këtë ekosistem, ku ndodhin këto fenomene të jashtëzakonshme, njeriu ndjen një lloj "inteligjence ekologjike", dhe mund ta vëzhgojë këtë rrjet si një dhuratë të dhënë nga një forcë përtej natyrës. Kur'ani thekson: **"Nuk ka asnjë gjallesë që lëviz mbi tokë, e cila të mos ketë furnizimin e saj nga Allahu."** (Hud, 11/6) Said Nursiu shpjegon këtë mesazh duke vënë në dukje: "Një pemë jep frytet saj jo për jetën e vet, por për të tjerët. Kjo tregon se veprimi nuk i takon pemës, por është veprimi i Atij që furnizon gjithë krijesën."³

Pastruesit e Oqeanit: Rituali midis karavidheve dhe peshqve

Biologët detarë që studiojnë bregdetet e Australisë kanë vëzhguar karavidhet pastruese që futen në gojën e peshqve grabitqar për t'u hequr parazitët.⁴ Gjatë këtij pastrimi, peshku nuk e dëmton karavidhen; përkundrazi, ul kokën dhe pret shërbimin. Ky marrëdhënie, e ripërsëritur çdo ditë mbi themele besimi dhe sigurie reciproke, ngjan si një marrëveshje e heshtur e nënshkruar midis tyre dhe shfaq një model të qartë të besnikërisë që flet si për arsyen, ashtu edhe për ndërgjegjen.

Ushtarët mbrojtës të bimëve: Ritmi i bashkëpunimit mes pemës akacia dhe milingonave

Në savanat e Afrikës, pemët e Akacias së llojit *Vachellia* kanë gropëza të vogla në trung. Milingonat që jetojnë në këto gropëza mbrojnë pemën nga kafshët që hanë gjethet, ndërsa në këmbim, pemët prodhojnë për ta një nektar të ëmbël. Kjo marrëdhënie nuk është thjesht një reagim mekanik; ajo ngjan me një marrëveshje të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së përbashkët.⁵

Këtu lindin disa pyetje natyrshëm: pse milingona mbron një tjetër specie? Pse pemët prodhojnë struktura dhe substanca kimike që shërbejnë për jetën e një krijese tjetër? Nga vjen aftësia e tyre për të gjetur këtë habitat dhe për ta transmetuar atë brezave të ardhshëm? Said Nursiu përgjigjet: "Nga grimcat më të vogla deri te yjet, gjithçka qëndron mbi bashkëpunim reciprok. Ky bashkëpunim realizohet me urdhrin e një Fuqie të Vetme."⁶

Sakrifica në shkallë mikro: Ndhima e programuar dhe apoptoza në qeliza

Në trupin e njeriut, çdo ditë miliona qeliza sakrifikojnë ekzistencën e tyre për mirëqenien e organizmit. Në biologji, kjo quhet apoptozë – vdekja programuar e

qelizës. Vetë fjala "programuar" tregon se ky proces ndjek një rregull të shkruar. Ky fenomen nuk është thjesht refleks biologjik; ai është një akt vetëfljimi në shërbim të tërësisë.⁷ Shkaqet e apoptozës përfshijnë dëmtime gjenetike, infeksione, substanca toksike dhe sinjale nga sistemi imunitar. Funksionimi i rregullt i këtij procesi është jetik për shëndetin e organizmit; ndërsa çrregullimi i tij mund të shkaktojë sëmundje të rënda si kanceri, sëmundjet autoimmune dhe ato neurodegenerative.

Edhe në nivelin molekular, kjo lloj sakrifice kuptimplotë dëshmon se nga qelizat më të vogla deri tek pemët dhe kafshët gjigante, çdo aspekt i jetës vepron nën dritën e një dijeje dhe fuqie të pakufishme, duke zbatuar një etikë mëshirëdhënëse dhe të urtë që mbizotëron në gjithë natyrën.

Mendja e bashkëpunimit dhe nënshkrimi i krijimit

Për një studiues që sheh natyrën me sy të drejtë dhe lexon me thellësi librin e saj të fshehtë, e vërteta është kjo: jeta nuk bazohet mbi luftë, por mbi bashkëpunim. Ky rend i përsosur ku të gjitha krijesat prekin njëra-tjetrën nuk mund të jetë thjesht një mekanizëm i rastësishëm. Kur'ani thotë: **"Ne nuk e krijuam qiellin, tokën dhe çfarë ndodhet midis tyre për lojë dhe zbavitje."** (Enbija, 21/16) – duke na ftuar të shohim urtësinë dhe lidhjet midis krijesave si një sistem të qëllimshëm, jo një lojë të rastësishme. Bediuzzaman shprehet: "Libri i krijimit është një predikim i fuqisë së Zotit; çdo fjali tregon një mrekulli. Bashkëpunimi dhe solidariteti në të është nënshkrimi i një Zoti të Mëshirshëm."⁸

Për ata që e vëzhgojnë kujdesshëm natyrën, harmonizimi i saj mund të shihet si një sallë ekspozite e mjeshtërisë së lartë. Tani lindin pyetje që çdo mendje e ndjeshme duhet t'i ballafaqojë: a mundet ky bashkëpunim i rregulluar të shpjegohet vetëm me ligje natyrore të verbra? A mund të shpjegohet sakrifica e një krijese për tjetrën vetëm me hormone apo instinkt biologjik? Dhe nëse po, kush dhe pse ka vendosur këtë ekuilibër kaq të hollësishëm dhe preciz?

Kur'ani jep përgjigjen: **"Pa dyshim, në qiej dhe në tokë ka shumë argumente për besimtarët për fuqinë dhe urtësinë e Allahut."** (Xhathije, 45/3-4) Bediuzzaman e përmbyll me një reflektim të thellë: "Shiko vetveten; të gjitha organet e trupit bashkëpunojnë. Shiko gjithësinë; të gjitha krijesat ndihmojnë njëra-tjetrën. Ky bashkëpunim i mëshirshëm dëshmon për ekzistencën e një Zoti Absolut të Mëshirshëm."⁹

3. Said Nursi, B., po aty.

4. Grutter, A. S. (2020): Cleaning mutualisms in the marine world. *Annual Review of Marine Science*.

5. Palmer, T. M. et al. (2018): A keystone mutualism underpins tropical forest biodiversity. *Science Advances*.

6. Said Nursi, B., po aty.

7. Elmore, S. (2007): Apoptosis: A Review of Programmed Cell Death. *Toxicologic Pathology*.

8. Said Nursi, B., po aty.

9. Po aty.

A LEJOHET QË PARATË QË KAM DHËNË BORXH T'I QUAJ ZEKAT?



Në kushte normale, që zekati të konsiderohet i dhënë duhet të realizohet dorëzimi dhe kalimi i pronësisë (temlik) i pasurisë. Kjo zakonisht bëhet duke ndarë shumën e zekatit dhe duke ia dorëzuar drejtpërdrejt një personi në nevojë. Në rastin kur thjesht falet një borxh, nuk ndodh dorëzim real i pasurisë dhe për këtë arsye shumica e dijetarëve klasikë nuk e kanë lejuar që falja e borxhit të llogaritet si zekat.

Për më tepër, për të shmangur keqkuptime apo situata që mund ta detyrojnë njeriun t'ia japë zekatin pikërisht personit që i ka borxh, është më e udhës që borxhi dhe zekati të trajtohen veçmas. Zekati është një adhurim që kërkon sinqeritet dhe largim nga çdo llogari apo interes personal.

Megjithatë, në kohët tona, për shkak se marrëdhëniet e borxh-dhënies janë shumë të përhapura, disa juristë bashkëkohorë i kanë dhënë përparësi mendimit të Hasan el-Basri, i cili ka qenë i mendimit se shumica e borxhit mund të llogaritet si zekat nëse bëhet fjalë për një marrëdhënie të thjeshtë borxh-dhënieje dhe jo për marrëdhënie tregtare. Përfundimi i rasteve tregtare bëhet për të shmangur mundësinë e abuzimit, që zekati të mos kthehet në një formë të planifikuar shlyerjeje borxhesh. Sepse mund të kthehet në punë të përvitshme që personat ta kthejnë zekatin në një trajtë shpagimi, duke bërë llogari të ngjashme me paramendim, ende pa iu caktuar vetë zekati si farz, apo edhe shumica e tij.

Nëse ndiqet ky mendim, është e rëndësishme që borxhliu të vihet në dijeni

dhe të japë pëlqimin e tij. Kjo lidhet me parimin e temlikut dhe me respektimin e dinjitetit të tij. Pëlqimi (rida) mund të shprehet me fjalë ose thjesht duke pranuar këtë zgjidhje. Si dhe nëse ai nuk e pranon, atëherë detyrimi i zekatit nuk konsiderohet i përmbushur.

Një mënyrë tjetër që përmendet është, që personi t'ia japë zekatin borxhliut dhe ai më pas t'ia përdorë për të shlyer borxhin. Megjithatë, kjo nuk duhet të bëhet me kushtëzim apo marrëveshje të detyruar, sepse zekati nuk është një procedurë mekanike apo një llogari formale. Ky opsion ofrohet, sepse ndonjëherë kërkohet një zgjidhje e pranueshme për ngërçe të caktuara, të cilat mund të zgjidhen lehtësisht nëpërmjet paramendimit pozitiv dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

Pasi zekati është dhënë, borxhliu mbetet i lirë ta përdorë atë sipas nevojës së tij. Vetëm më pas kreditori ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e borxhit në mënyrë të zakonshme.

Në çdo rast, është e rëndësishme që veprimet të bëhen me sinqeritet, drejtësi dhe kujdes për ndjenjat e tjetrit, duke synuar jo vetëm përmbushjen formale të detyrimit fetar, por edhe ruajtjen e frymës së mëshirës dhe solidaritetit që qëndron në thelb të zekatit.

Mund të veproni në mënyrën që ju bën të ndiheni më të qetë në ndërgjegje. Allahu e di më së miri.

Familja

THEMELI BAZË I BASHKËSISË
NJERËZORE



Familja është institucion i frymëzuar nga Zoti i paraqitur qysh me krijimin e njeri- ut. Ajo nuk është zhvilluar përmes proceseve eksperimentale të evolucionit njerëzor e as rastësisht gjatë rrjedhës së kohës. Kjo është një e vërtetë e kumtuar nga mësimet hyjnore të shpallura nga Zoti dhe është

refuzim i tërësishëm i mësimëve evolucioniste, sipas të cilave jeta e njeriut ka filluar në ujë me bashkimin e rastësisht të miliona proteinave për të krijuar qelizën e parë të jetës.

Raca njerëzore është prodhim i këtij institucioni e nuk është institucioni prodhim i racës njerëzore. "O njerëz, bëhuni respektues e të bindur ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një individi, kurse prej tij krijoi gruan, e ndërsa prej tyre krijoi dhe shpërndau shumë burra e gra. Kini frikë Allahun në emrin e të Cilit përbetoheni. Vërtet, Allahu është Mbikëqyrësi juaj..."

Familja është sistemi më i vjetër shoqëror, sepse ajo arrin deri te familja e parë e Ademit (paqja qoftë mbi të!), e cila ishte bërthamë e tërë shoqërisë njerëzore.

Familja në secilën fe dhe secilin rregullim social pranohet si gurë themel në shoqëri.

Edhe feja islame shumë shpesh fokusohet te rëndësia e familjes dhe e konsideron atë si kala mbrojtëse përballë jetës boheme, sepse familja është vendi ku natyra njerëzore mundet ta shprehë veten në mënyrën më të mirë, ku mundet t'i realizojë dhe kthejë në praktikë vlerat e larta si: dashuria, respekti, dhembshuria, sakrifica, besnikëria dhe bindja. Afërsisht një e treta e rregullave juridike të

Kur'anit kanë të bëjnë me familjen dhe rregullimin e harmonisë së saj.

Kurani tregon për ambientin e qetësisë, prehjes shpirtërore, të mëshirës dhe të dashurisë, të cilën e formon sistemi familjar dhe ai e bën këtë sistem një argument prej argumenteve të urtësisë, të fuqisë dhe të madhësisë së Allahut.

"Dhe nga shenjat e (madhësisë së) Tij është për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë) ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë." (30: 31)

Sistemi i familjes islame i vendos të drejtat e burrit, gruas, fëmijëve dhe të afërmeve në një ekuilibër të përsosur dhe këto marrëdhënie nga aspekti juridik dhe moral janë të shpjeguara deri në detajet më të imëta. Ai ushqen tek individi bujarinë, dashurinë dhe sjelljet jo egoiste në kuadrin e një familjeje të

organizuar mirë. E gjithë kjo ka për qëllim që

shoqëria myslimane të ndërtohet mbi themele të shëndosha, pasi qetësia dhe siguria e ofruar nga një familje e stabilizuar ka vlerë të jashtëzakonshme dhe është thelbësore për anëtarët e saj.

Pa ekzistencën dhe përkrahjen e një familjeje të shëndoshë nuk mund të realizohet kurrë harmonia në një shoqëri.

Vetëm në kuadër të familjes potenciali shpirtëror i burrit dhe gruas bëhet realitet dhe zhvillon pastërtinë morale brenda dhe jashtë saj.

Familja në kontekstin islam është një strukturë e veçantë, parimet e së cilës janë lidhur me njëri-tjetrin përmes lidhjeve të gjakut dhe marrëdhënieve bashkëshortore, lidhshmëria e të cilave është e një natyre të atillë sa të kërkojë "kërkesa të ndërsjella", që janë caktuar nga feja, të përforcuara nga ligji dhe të ndërtuara nga individi.

Struktura familjare në fenë islame është e ndërtuar mbi baza të shëndosha, me qëllim të suksesit dhe vazhdimësisë së saj. Këto baza janë:

1. Besimi. Me anën e besimit dhe Sheriatit, secili nga bashkëshortët i di të drejtat dhe obligimet e veta dhe ka para vetes një program të qartë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Burri dhe gruaja plotësojnë njëri-tjetrin dhe respektimi i përbashkët i vlerave të martesës dhe besnikëria në mes

bashkëshortëve janë elementet kryesore që e fuqizojnë paqen dhe harmoninë në jetën bashkëshortore.

Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Më i miri (më i dobishmi) prej jush është ai që është më i mirë për gruan (familjen e tij), e unë jam më i miri nga ju për familjen time". Po ashtu ka thënë: "Kjo botë është kënaqësi dhe kënaqësia më e mirë e saj është gruaja e mirë. Kur e shikon atë, e gëzon, kur i kërkon diçka e dëgjon dhe, nëse nuk është i pranishëm, ia ruan nderin dhe pasurinë".

2. Martesa me pëlqim të dyanshëm, sepse vetëm një martesë e tillë do të jetë e suksesshme.

Islami e ndaloj imoralitetin dhe ndërmori masa të ashpra për ndalimin e tij, sepse imoraliteti është sulm i hapur ndaj sistemit të familjes dhe shenjtërisë së saj. Kështu, Islami hapi dyert për formimin e familjeve duke iu përgjigjur natyrës së njeriut me të cilën Allahu i krijoi njerëzit.

Kur'ani shpjegon se martesë ishte traditë e përgambrëve në ajetin vijues:

"Ne dërguam edhe para teje të dërguar dhe atyre u mundësua të kishin gra e fëmijë..." (13: 38).

Në ditët tona familja, e cila është epiqendra e shoqërisë, ndodhet përballë një sërë sulmesh bashkëkohore. Tregtarët e epshit, të cilët pandehin se mbrojnë të drejtat e vajzave dhe grave, duke zhvilluar armiqësi veçanërisht ndaj Islamit, në çdo rast të përshtatshëm e paraqesin martesën si të keqe dhe kërkojnë të asgjësojnë ndikueshmërinë dhe efektivitetin e familjes. Një numër i madh

njerëzish të rënë në grackën djallëzore të ngritur nga ata që e përdorin femrën si mjet kënaqësie e dëfrimi, duke u dhënë pas kërtimeve jashtë familjes dhe Islamit, kryejnë të gjitha llojet e mëkateve në emër të të ashtuquajturit qëndrim bashkëkohor.

Prandaj, martesë është e vetmja mënyrë që bashkëshortët në jetën e tyre të përbashkët të gjejnë kënaqësinë dhe qetësinë e tyre, ta plotësojnë njëri-tjetrin, ndërmjet tyre të ketë dashuri dhe butësi të ndërsjellë, të bëjnë mirëmbajtjen e brezave të ardhshëm dhe të kryejnë të tjera detyra madhështore.

Jeta bashkëshortore është themeli i familjes, kurse familja themeli i bashkësisë njerëzore.

Se sa e rëndësishme është, për sa i përket njeriut, familja e formuar si rezultat i martesës, pohohet me këto fjalë në Kur'an:

"...ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato..." (Bekare, 187)

Profeti Muhamed a.s. në lidhje me këtë thotë: "Kush ka mundësi për martesë, le të martohet, ngase martesë i mbron sytë nga harami deri në pikë të fundit. Gjithashtu e ruan nderin dhe moralin deri në një shkallë. Ndërsa kush nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë pasi agjërimi e shuan epshin".

3. Përgjegjësia e përbashkët. Martesë obligon përgjegjësi të caktuara, të cilat i përkufizon Sheriati.

Për këtë feja islame i jep rëndësi hapave të parë të krijimit të familjes duke zgjedhur elementet e shëndoshë, të cilët do të mbajë

shtrënguar fort njëri e shenjtë (lidhjen martesore).

Po cila është përgjegjësia themelore e burrit dhe gruas?

Ato zërthehen në terma të gjerë e të përgjithshëm. Me qëllim që të mos ketë anarki dhe çrregullim në udhëheqjen e çështjeve të familjes. Islami udhëheqjen e këtij institucioni dhe mbrojtjen e tij ia caktoi burrit, pasi ai është më i fortë që të ballafaqohet me vështirësi dhe peripecitë e punëve të

ndryshme gjatë kërkimit të rrizkut në tokë dhe gjithashtu, sepse burri ka një përvojë më të madhe në njohjen e gjendjes së njerëzve dhe të jetës për shkak të natyrës së krijimit të tij dhe rolit të tij në shoqëri.

Allahu i Madhëruar thotë: "Burrat janë mbrojtësit dhe mbajtësit e grave".

Kjo në asnjë mënyrë nuk duhet të kuptohet si sundim apo nënshtrim, por do të thotë sistematizim e radhitje e përgjegjësive, pasi ideja për superioritetin mashkullor në raport me atë femëror, në fenë islame nuk qëndron, ngase kodi islam ka rregulluar mjaft mirë raportet mes burrit dhe gruas ku secilit prej tyre i ngarkoi përgjegjësi të ndara, jo për ta ulur njëri-tjetrin, por për t'u realizuar formula

hyjnore "gjetja e prehjes dhe e qetësisë mes njëri-tjetrit".

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Të gjithë jeni rojtarë dhe të gjithë jeni përgjegjës për të drejtat e atyre që janë në kujdesin tuaj. Udhëheqësit janë përgjegjës për gjithë atë që është nën pushtetin e tyre, përgjegjësi i familjes është përgjegjës për anëtarët e familjes së vet, ndërsa gruaja është përgjegjëse për familjen e saj."

Ndërsa përgjegjësitë e gruas janë:

Së pari, ajo ka përgjegjësi për kultivimin e situatës së shëndoshë në shtëpi për burrin dhe për fëmijët. Ajo është që dikton disponimin se si do të udhëhiqet shtëpia e si do të krijojë një atmosferë të shëndoshë e të qetë për familjen e saj.

Në Islam, burri për gruan e tij dhe gruaja për burrin e saj janë si një pëlhurë, e cila mbron secilin nga çdo gjë jashtë tyre. Kjo mbulesë

përfshin të gjitha aspektet, qofshin shpirtërore apo materiale.

Së dyti, përgjegjësia e saj është në rritjen e fëmijëve dhe edukimin e tyre. Përgjegjësitë e saj shtrihen deri në ballafaqimin me fëmijët, edukimin e tyre, të mësuarit atyre sjelljen, mbrojtjen e tyre, si dhe dallimin e asaj se ç'është mirë dhe ç'është e keqe. Duke i kultivuar të gjitha këto aspekte të rëndësishme në jetën e tyre të përditshme ata do të rriten në mënyrë të pastër dhe të sigurt. Allahu

thotë në Kur'an: "O ju që keni besuar! Mbrojeni veten tuaj dhe familjet tuaja (do të thotë fëmijët, çiftin dhe kështu me radhë) nga zjarri."

Ndërsa i dërguari i Zotit porositi: "Fëmija edukohet 20 vjet para lindjes së tij", pra me edukimin e prindërve të tij.

Familja është shkolla e parë për edukimin e fëmijëve dhe se fëmija ka nevojë të domosdoshme për dashurinë e saj, ngase ajo e rrit, e frymëzon dhe i jep vullnet atij. Këtë e shohim në rastin kur familja është e shëndoshë, në shpirtin e fëmijës kultivohen ndjenjat e dashurisë, respektit, bashkëpunimit, vullneti i mirë për të tjerët, puna për të mirën e përgjithshme, si dhe sakrifica për hir të parimeve të larta.

Hulumtimet e shumta shkencore vërtetojnë se shumica e atyre që kanë devijuar dhe janë zhytur në rrugën e kriminalitetit, janë ata që nuk kanë pasur rastin të shijojnë ngrohtësinë familjare, si dhe nuk kanë pasur rast të edukohen me vlerat dhe ndjenjat e jetës së familjes së shëndoshë.

Dashuria dhe harmonia në martesë dhe në familje ku çdo anëtar i familjes i përmbush detyrat e tij familjare, është kënaqësi e vërtetë.

Joharmonia në familje rrjedh nga lënia e detyrimeve dhe përgjegjësive ndaj familjes si dhe nga mungesa e vetëdijes, e cila shkaktohet nga shkalla e ulët e edukatës morale, e pirjes se alkoolit dhe jobesnikërisë bashkëshortore.

Feja islame ka për qëllim të krijojë familje të shëndosha në shoqëri. Këto familje të shëndosha nuk mund të shkatërrohen lehtë dhe nuk bien lehtë nën ndikimin e streseve

shoqërore dhe morale dhe që mos shkojmë deri te shkatërrimi i familjes prej shtresave ideologjike, të cilat mundohen të depërtojnë në familjet tona, ne duhet ta forcojmë strukturën familjare.

Familja është institucion që i zhvillon lidhjet farefisnore ose të gjakut mes njerëzve, që i shndërron këto lidhje, në masë të madhe, në solidaritet shoqëror-ekonomik dhe mbështetje të dyanshme. Ka plot tekste kuranore dhe profetike që na obligojnë për sjellje të mirë, vizitë dhe kujdesje ndaj prindërve si dhe ndaj të afërmve.

Allahu i Madhërishëm thotë: "Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mirë ndaj prindërve të vet." dhe "Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë, që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë të denjë ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapluar pleqëria pranë kujdesit tënd,

atëherë mos u thuaj atyre as 'Of-Oh', as mos u bëj i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj:

"Zoti im, mëshiroji ata të dy sikurse më edukuan mua kur isha i vogël." (Isra: 23-24) Muhamedi (a.s.) ka thënë: "Mëkate të mëdha janë: t'i bësh shirk Allahut të Madhërishëm, mosrespektimi i prindërve dhe e vrasja e njeriut të pafajshëm".

Familja renditet në krye të institucioneve që kontribuojnë në njohjen e brezave me vlerat islame si dhe në formimin e shëndoshë dhe të qëndrueshëm të ndërrimeve shoqërore. Familjet e ngritura mbi vlera të larta si besnikëria, dashuria e sinqertë, bindja e vetëdijshme dhe morali i bukur, janë garancia më e madhe e shoqërisë islame. Fundja, ekzistenca e një institucioni matet me aktivitetin e tij.

Prej familjeve të lumtura burojnë rrezet e lumturisë në mbarë shoqërinë njerëzore, kurse fatkeqësinë e familjeve jo të lumtura e përjeton e tërë bashkësia apo shoqëria njerëzore.

TË JETOSH MES NJERËZVE DUKE QENË ME TË VËRTETIN

“Besimtari që jeton mes njerëzve dhe duron shqetësimet që i vijnë prej tyre ka shpërblim më të madh sesa besimtari që izolohet nga njerëzit dhe nuk duron shqetësimet e tyre.”

(Ibn Maxhe, Fiten 23; Tirmidhi, Kijame 55; Ahmed Ibn Hanbel, Musned, 2/43-5)

Besimtari që qëndron mes njerëzve dhe përballon vështirësitë që rrjedhin nga bashkëjetesa me ta është më i vlefshëm se ai që tërhiqet në vetmi dhe nuk i përballon këto sprova.

Bota ka disa aspekte. Njëri prej tyre është aspekti i saj i të qenit kalimtare dhe mashtruese, që e godet njeriun pa paralajmërim dhe përbëhet vetëm nga lojë dhe zbavitje. Ky është aspekti për të cilin njerëzit e dhënë pas dynjasë e adhurojnë atë, ndërsa besimtari duhet të ndiejë neveri ndaj saj.

Ekuilibri ndërmjet kësaj bote dhe botës tjetër duhet të vendoset nga këndvështrimi se kjo botë është e përkohshme, ndërsa bota tjetër është e përgjeshme. I Dërguari i Allahut ﷺ nuk e braktisi kurrë jetën shoqërore, por gjithmonë jetoi mes njerëzve duke qenë në shoqëri të përhershme me të Vërtetën Hyjnore. Ai vetë ka theksuar se durimi i vështirësive që vijnë nga jeta mes njerëzve është


më i vlefshëm se izolimi në vetmi.

Edhe ne duhet të veprojmë kështu. Të lëvizim mes shoqërisë, të marrim pjesë në jetën arsimore dhe kulturore si mësues e nxënës, të përballojmë vështirësi shpirtërore, të sakrifikojmë për të mirën morale dhe shpirtërore, madje ndonjëherë edhe të heqim dorë nga përfitime personale për hir të afrimit me Allahun. Në këtë mënyrë, duke u edukuar me moralin e të Dërguarit të Tij ﷺ, ne përpiqemi të përfaqësojmë të vërtetën e madhe që ai solli.

Ata që këmbëngulin në këtë qëndrim, edhe pse jetojnë mbi “zjarrin” e kësaj bote, nuk mashtrohen kurrë nga aspekti i saj kalimtar dhe i rremë. Ata jetojnë mes njerëzve, por janë gjithmonë me Allahun.

Edhe kur e gjithë bota iu shtrua nën këmbë, i Dërguari i Allahut ﷺ nuk u josh nga komoditeti dhe luksi i saj. Jeta dhe ndarja e tij nga kjo botë ishin në të njëjtën linjë thjeshtësie. Ai jetoi me përlësi dhe u nda nga kjo botë po me të njëjtën thjeshtësi.

I Dërguari i Allahut ﷺ, gjatë gjithë jetës së tij, u përpoq të ndërtonte një rend të balancuar që do t’u shërbente qytetërimeve. Ai nuk bëri asnjë kompromis me këtë mision dhe ia kushtoi jetën



fitimit të kënaqësisë së Allahut dhe shpëtimit të njerëzimit.

Në një rast, Omeri (r.a.) e pa Profetin ﷺ duke pushuar mbi një rrogaz të thjeshtë dhe u përlot. Kur Profeti ﷺ e pyeti për arsyen, ai u përgjigj se perandorët jetonin në luks, ndërsa Profeti i Allahut ﷺ jetonte në thjeshtësi. Ai iu përgjigj: “A nuk dëshiron, o Omer, që bota të jetë e tyre, ndërsa bota tjetër e jona?”

I Dërguari i Allahut ﷺ nuk e braktisi botën, por e pa të vërtetën hyjnore në çdo gjë dhe e shpalli atë në mbarë botën.

Edhe sot, studimet sociologjike tregojnë se njerëzimi përparoi ndjeshëm me ardhjen e Profetit Muhamed (paqja qoftë mbi të), duke arritur një zhvillim që nuk ishte arritur ndër shekuj. Kjo e dëshmon rolin e tij si udhërrëfyes i përhershëm për njerëzimin.

Ai nuk e braktisi botën, por e vendosi çdo gjë në vendin e duhur. Ai e mësoi umetin (pasuesit) se durimi është forca që e shfaq vullnetin e njeriut dhe se përmes durimit njeriu arrin pjekurinë dhe përkryerjen shpirtërore.

Durimi është një forcë mbështetëse te njeriu, domethënë, njeriu e shfaq vullnetin e tij vetëm përmes durimit. Madje, përmes tij, ai fiton një

gjendje dhe cilësi të tillë, saqë falë saj shfaqet forca e fshehur në shpirtin e tij. Sipas gjërave ndaj të cilave ushtrohet, durimi ndahet në disa lloje.

I pari është durimi ndaj vazhdimësisë së adhurimit dhe bindjes ndaj Zotit.

I dyti është durimi ndaj mëkatit. Ky lloj durimi është veçanërisht i rëndësishëm për rininë e sotme. Sidomos në periudha kur mëkatet depërtojnë në zemrat tona nëpërmjet shikimit dhe kur tundimet janë të përhapura gjerësisht, qëndrueshmëria ndaj mëkatit, mos rrëshqitja e shpeshtë në gabime dhe mos lëkundja përballë mëkateve përbëjnë një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme.

I treti, dhe më i vështiri ndër të gjitha format e durimit, është durimi ndaj fatkeqësive dhe sprovave. Domethënë, durimi i njeriut ndaj gjërave që Allahu i ka caktuar dhe i ka vënë përballë tij.

I katërti është durimi ndaj stolisjes dhe shkëlqimit të kësaj bote, si dhe ndaj dëshirave që ushqejnë egon dhe epshin. Ky është një lloj heroizmi i përgjithshëm.

I pesti është durimi ndaj ndjenjave të begatave materiale dhe shpirtërore, i cili u takon vetëm njerëzve të përsosur.

MYSLIMANËT, TË PARËT QË DENONCUAN KOMUNIZMIN

Gjatë këtyre viteve të demokracisë, është folur shumë në lidhje me krimet dhe dëmet e komunizmit, por pak është bërë në fushën e studimeve me fakte nga arkivat dhe dokumentet e shumta. Që në 1925, shumë më parë se komunizmi të hidhte farë e rrënjë në Shqipëri, paralajmërimin më të parë e ka dhënë në mënyrën më alarmuese dijetari dhe patrioti antikomunist, Hafiz Ali Korça, me librin e tij “Bolshevizma a çkatërimi i njerëzimit”. Ndër të tjera Hafiz Aliu në këtë libër konstaton:

Bolshevizma s'pajton kurrë
Me dinin e Muhamedit
Çelët do ta kenë luftën
Gjer në ditën e Kijametit.

Po kështu do të bënin edhe shumë atdhetarë të tjerë dhe prijës fetarë, duke e ngritur zërin në organin zyrtar të Komunitetit Mysliman Shqiptar që nga themelimi 1923 deri më 1939, në revistën kombëtare “Zani i Naltë”. Zhdukja e fesë ishte thelbësore për injektimin e dogmës komuniste dhe rrjedhimisht, për krijimin e “njeriut të ri”. Megjithatë, komunistët e dinin se në pjesën dërrmuese të popullsisë, feja zinte një vend mjaft të rëndësishëm. Regjimi komunisto-ateist, që u vendos në Shqipëri në vitin 1944, pati në shënjestër të tij zhveshjen nga të gjitha vlerat njerëzore, që Zoti ia kishte dhuruar krijesës më të shkëlqyer të Tij, njeriut, duke ia marrë ky sistem me dhunë dhe duke e kthyer në një robot të varfër në shpirt, të varfër në materie.

Komunistët e filluan regjimin e tyre me terrorin apo masakrën e Tiranës në 1944, ku u pushkatuan një numër i madh intelektualësh dhe i pari që u vra ishte hoxha i Saukut, Hafiz Selim

Braja. Sistemi totalitar filloi një luftë të paparë ndaj fesë, duke bërë një propagandë antifetare dhe duke filluar një persekutim të egër ndaj klerit fetar në përgjithësi.

Kështu si shumë drejtues të tjerë fetarë, edhe ndaj klerit mysliman filloi një goditje e parapërgatitur, duke arrestuar dhe dënua fillimisht drejtuesit dhe pedagogët e medresesë së vetme, atë të Tiranës, siç ishin H. Ismet Dibra burgosur më 1946, H. Ali Korça më 1945, Jonuz Bulej më 1947, Enver Beqirit më 1946, Vexhi Buharajë më 1947, Shaban Demirit më 1946, etj.

Pas ndërhyrjeve të dhunshme të shtetit në organizimin e jetës së Komunitetit Mysliman Shqiptar, sekuestrimit të pronave, kontrollit mbi buxhetin, ndalimi i literaturës, kufizimi i rreptë dhe kontrolli mbi Medresenë, politika komuniste forcoi një propagandë të ashpër “demaskuese” nëpërmjet shtypit, radios, formave të edukimit, kinemasë, pjesëve të leximeve shkollore dhe edukimit me përbuzjen ndaj fesë. Klerikët myslimanë gjatë regjimit komunist përjetuan ngjarje tronditëse. Shumë prej udhëheqësve dhe dijetarëve më me ndikim, Sigurimi i Shtetit i ndoqi, u nxori dëshmitarë të rremë nëpër gjyqe të sajua, i pushkatoi, dënoi e internoi, duke mbjellë një atmosferë të përgjithshme terrori.

Kështu më 1967 Shqipëria u bë vendi i parë ateist në botë, duke shkatërruar shumicën e kishave, xhamive dhe teqeve. Nga 1127 xhami që ishin në 1967, në 1990 kishin mbetur vetëm disa, të shndërruara dhe përçudnuara në depo, magazina, apo të braktisura.

Në stilin e tyre komunistët gjithashtu e përqendronin goditjen në kokat e elitës fetare

myslimane. Sipas statistikave vetëm gjatë dhjetë vjetëve të parë të diktaturës janë pushkatuar e dënuar 60 hafizë e hoxhallarë, si dhe ka një numër të madh të internuarish. Këta dhjetëra të vrarë dhe qindra të internuar nga ky besim i bashkëngjiten martirëve të parë të lirisë dhe besimit në pikun më të ashpër të diktaturës komuniste.

Disa prej figurave më përfaqësuese publike të myslimanëve shqiptarë, u ekzekutuan me vdekje nga gjyqet komuniste midis një histerie popullore në sallën e gjyqit dhe jashtë, duke i përcjellë akuza dhe shpifje banale me megafon e radiotransmetim, për të mbjellë terror në gjithë Komunitetin Mysliman. Të tilla ishin gjyqet e vitit 1947 kur u dënua me pushkatim me akuzën stampë "armik i popullit", deputeti sheh Ibrahim Karbunara bashkë me të birin Hasanin.

Shumë të tjerë vdiqën nëpër burgje. Nuk duhet harruar se te gjithë këto ishin të shkolluar në universitetet më të mira të botës islame, dhe një pjesë e tyre ishin edhe firmëtarë të pavarësisë, siç ishte edhe mësuesi i medresesë dhe eruditi Ferit Vokopola.

Ndër figurat më të shquara mund të përmendim:

1. Hafiz Ali Korça (Drejtor Arsimi, Kryemyfti, publicist, shkrimtar e poet, burgosur në vitin 1945),
2. Hafiz Ibrahim Dalliu (themelues i shkollave shqip në Tiranë, burgosur në vitin 1946),
3. Hafiz Ismet Dibra, (drejtor i Medresesë së Përgjithshme, Tiranë, burgosur në vitin 1946),
4. Hafiz Sabri Koçi (burgosur në vitin 1966, bëri 20 vjet e 4 muaj burg, kryetar i parë i KMSH-së pas komunizmit, 1990-2003),
5. Haki Sharofi, kryeredaktor i revistës "Zani i Naltë" (burgosur në vitin 1946),
6. Ismail Muçej (poliglot gjuhësh, burgosur në 1952 –1963),
7. Haxhi Faik Hoxha (burgosur në 1966),
8. Hasan Tahsini (drejtues në medrese, burgosur në vitin 1947),
9. Hafiz Mustafa Varoshi (myfti i Durrësit, burgosur në vitin 1945),
10. Hafiz Sherif Lëngu (kryetar i Këshillit të Naltë të Sheriatit, burgosur në vitin 1945),
11. Hafiz Esat Myftia, (kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar, burgosur në vitin 1946),
12. Hafiz Musa Dërguti (burgosur në vitin 1946),
13. Hafiz Ali Kraja (burgosur në vitin 1945),
14. Imam Met Troci (vdekur në burg më 1947),

15. Sheh Ibrahim Karabunara (vlarë në burg më 1947),

16. Sheh Myslim Luma (vdekur në burg më 1953),

17. Imam Ahmet Hyseni (vdekur në burg më 1945),

18. Hafiz Xhemal Naiçi (Kadi, kryetar komisioni i arsimit, myfti, drejtor i përgjithshëm i Vakfeve, senator, deputet, kryetari i parë i parlamentit pluralist më 1921, i dënuar më 1947 nga Gjykata Ushtarake me privim lirie për jetë, me punë të detyruar, humbjen e të drejtave civile e politike-vdiq në burgun famëkeq të Burrelit në vitin 1955 në moshën 77 vjeçare, pa pasur familjarët dijeni as për varrin e tij).

Ndërsa Hafiz Sheuqet Boriçi, Hafiz Sabri Bushati, Molla Alush Zaganjori, etj., u vetëizoluan në shtëpi deri në vdekje, për të mos u zhveshur nga petku fetar.

Hafiz Musa Dërguti, thoshte: "Më kërkojnë me folë për priftin, dojnë me na përça, e nesër me thanë se u pushkatuen priftët me dëshmitë e hoxhallarëve. U kam thanë bani çka të doni, se atë punë s'e baj kurr."

Klerikët myslimanë u bënë kurban të besimit të tyre, besnikë deri në fund të jetës së tyre ndaj besimtarëve që përfaqësonin, por edhe të brumosur me dashurinë ndaj atdheut. Ata nuk pranuan asnjë kompromis me regjimin, i qëndruan besnikë fesë së tyre, atdheut dhe kombit, për të cilin shpirti i tyre mbeti i hapur dhe i lirë.

Sot, pas gjenocidit gjysmëshekullor mbi fenë, në kushtet e sotme të lirisë së besimit, ata dëshmorë të besimit dëshmuan të vetmin dinjitet njerëzor e kombëtar përpara Zotit dhe popullit të tyre. Prandaj ata duhet të kujtohen jo vetëm me lutjet tona, por edhe me studime të ndryshme. Sot akoma nuk njihen veprat e tyre. Vetëm disa nga veprat e H. Ali Korçës janë botuar në Shkup, dhe shumë pak libra të dijetarëve të tjerë janë botuar në Shqipëri nga Komuniteti Mysliman, apo botues individual.

Shoqëria jonë nuk ka mundur t'u shlyejë borxhin e dinjitetit dhe mirënjohjes këtyre baballarëve shpirtërorë të kombit. Por një borxh dhe detyrë më të madhe i ka shteti këtyre njerëzve, sepse klerikët nuk janë monopol i komuniteteve fetare, por i përkasin të gjithë shqiptarëve, brezat e rinj të të cilëve duhet të njihen nëpërmjet librave të historisë dhe letërsisë në shkollat e vendit, sepse ata shërbyen me filozofinë e binomit "Për fe e atdhe".

FEJA MIDIS FILOZOFISË SË JETËS DHE DOGMËS

Njeriu, si qenia më e përkryer e këtij universi, është dërguar për të jetuar në tokë deri në një afat të caktuar. Me ardhjen e tij në këtë botë, lind natyrshëm nevoja për një manual jetësor, përmes të cilit njeriu të dijë se si të jetojë në përputhje me ligjet hyjnore dhe parimet morale, në mënyrë që të ketë sukses si në këtë botë, ashtu edhe në tjetrën.

Për këtë arsye, Allahu (xh.sh), gjatë gjithë historisë njerëzore, ka dërguar profetë të pajisur me shpallje dhe udhëzime jetësore, në mënyrë që njerëzit të jenë të informuar për atë që Krijuesi kërkon prej tyre. E njëjta traditë ka vazhduar deri te shpallja e profetit të fundit, Muhamedit (a.s.), dhe zbritja e Islamit si fe përfundimtare.

Ajo që vërehet qartë në traditën e shpalljes hyjnore përgjatë historisë, e veçanërisht në legjislacionin islam, është se feja nuk ka ardhur thjesht si një sistem urdhrash dhe ndalimesh, por si një udhëzim i gjithanshëm për mendjen, zemrën dhe jetën e njeriut.

Kjo nënkupton se feja synon të kultivojë te njeriu parimet më të larta morale, duke e bërë atë që direktivat hyjnore t'i shndërrorë në pjesë përbërëse të filozofisë së tij të jetës. Prandaj, është tejet e rëndësishme që feja të kuptohet si një filozofi jete, e cila e përfshin njeriun në të gjitha dimensionet e ekzistencës së tij, dhe jo si një shabllon apo dogmë e ngurtë, ku mbizotëron forma mbi shpirtin dhe kuptimin.

Këtu lind me të drejtë pyetja themelore:

A duhet feja të kuptohet si filozofi e jetës që formëson moralin, ndërgjegjen dhe sjelljen e njeriut, apo si një shabllon i thatë, ku forma mbizotëron mbi kuptimin?

Vetë Kurani e ngre këtë çështje kur thotë:

**“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?”
(Zumer, 9)**

Ky ajet nuk flet vetëm për dije formale, por për vetëdije, reflektim dhe thellësi mendimi. Ai i referohet kuptimit të drejtë të qëllimit të jetës, ku njeriu i ditur dhe i mençur konsiderohet ai që nuk ia atribuon rastësisë krijimin e universit me gjithë harmoninë e tij, por e lidh atë me Zotin, Krijuesin e botëve.

Prandaj, shpallja hyjnore nuk i barazon ata që reflektojnë me ata që vetëm imitojnë në mënyrë të verbër. Çdo shpallje hyjnore është në përputhje të plotë me intelektin dhe logjikën e pastër njerëzore. Njeriu që arrin një kuptim të thellë të qëllimit të jetës dhe filozofisë së saj, që është i aftë të kuptojë urtësitë e gjithçkaje që e rrethon, në Islam konsiderohet i begatuar nga Zoti.

Kjo sepse jeta nuk është një proces mekanik. Ajo përmban pafundësi rrugësh dhe mundësish, të cilat, në varësi të zgjedhjeve tona, mund t'i japin asaj ngjyrat më të bukura ose, përkundrazi, ta errësojnë atë.

Këtë kërkon Islami prej njerëzve: që, përmes udhëzimit hyjnor, të dinë t'i japin jetës ngjyrat e duhura, të kuptojnë urtësinë e marrëdhënies mes krijesës dhe Krijuesit dhe të synojnë lumturinë në të dy botët. Kështu e përshkruan Kurani këtë realitet:

“Ai ia dhuron urtësinë kujt të dojë, e kujt i është dhënë urtësia, atij i është dhuruar një mirësi e madhe. Këtë e kuptojnë vetëm të mençurit.” (Bekare, 269)

Edhe pse këto janë parime universale për çdo njeri, besimtari ka një përgjegjësi edhe më të madhe për t'i kuptuar drejt direktivat hyjnore dhe urtësitë që qëndrojnë pas tyre.



Një shembull domethënës i kësaj qasjeje gjendet në hadithin e njohur mbi veshjen poshtë nyjës së këmbës. Profeti (a.s.) ka thënë:

“Çfarë bie poshtë nyjës së këmbës nga rrobat, është në Zjarr.”

Në pamje të parë, hadithi duket absolut. Mirëpo, kur Ebu Bekri (r.a.) shprehu shqetësimin se rrobat e tij ndonjëherë i binin poshtë pa qëllim, Profeti ﷺ ia sqaroi çështjen duke thënë:

“Ti nuk je prej atyre që e bëjnë këtë nga mendjemadhësia.” (Buhariu)

Ky sqarim na tregon një parim themelor të praktikës islame: në Islam, forma gjykohet përmes qëllimit dhe nuk mund të ndahet prej tij. Nga ky transmetim kuptojmë se çdo veprim i shoqëruar me mendjemadhësi është i dënueshëm, sepse mendjemadhësia përmban nënçmim ndaj të tjerëve dhe, në çdo formë që manifestohet, konsiderohet gjynah i madh tek Allahu (xh.sh).

Kurani e thëllon këtë dallim kur thotë:

“Vallë, a është ai që ishte i vdekur e Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë me të cilën ecën mes njerëzve, si ai që ka mbetur në errësira dhe nuk mund të dalë prej tyre?” (En’am, 122)

Feja e kuptuar si filozofi jete është dritë që ndriçon arsyen, edukon moralin dhe e bën njeriun të vetëdijshëm për veprimet e tij. Ndërsa feja e reduktuar në shabllone të thata rrezikon të shndërrohet në errësi, ku forma ruhet, por kuptimi dhe urtësia humbasin.

Profeti Muhamed (a.s.) e ka vendosur qartë kriterin e vlerësimit kur ka thënë:

“Allahu nuk i shikon pamjet dhe trupat tuaj, por i shikon

zemrat dhe veprat tuaja.” (Muslimi)

Ky hadith rrëzon çdo përpjekje për ta matur devotshmërinë vetëm përmes pamjes së jashtme. Format dhe detajet kanë vendin e tyre, por nuk përbëjnë thelbin. Thelbi është zemra, sinqeriteti, përpulësia dhe drejtësia.

Feja dhe konteksti kulturor

Një tjetër parim themelor kuranor thotë:

“Ne asnjë të dërguar nuk e dërguam ndryshe, veçse në gjuhën e popullit të vet, që ai t’ua shpjegojë atyre.” (Ibrahim, 4)

Ky ajet tregon se feja respekton kontekstin, kulturën dhe traditën, për aq kohë sa ato nuk bien ndesh me parimet themelore të besimit dhe moralit. Islami nuk erdhi për të shkatërruar traditat e bukura, por për t’i pastruar, përmirësuar dhe për t’u dhënë kuptim.

Importimi i verbër i traditave të huaja, të shkëputura nga teksti dhe realiteti lokal, shpesh krijon përplasje të panevojshme mes fesë dhe shoqërisë. Feja nuk duhet të shfaqet si e huaj në shtëpinë e njerëzve të saj, por të depërtojë natyrshëm në zemrat e atyre që kërkojnë njohjen e Krijuesit.

Kur feja shndërrohet në dogmë, teksti shkëputet nga qëllimi, njeriu gjykohet nga pamja dhe jo nga morali, ndërsa dija zëvendësohet me imitim. Në këtë rast, humbet qëllimi thelbësor i mesazheve universale hyjnore. Ndërkohë, Kurani dhe Suneti na thërrasin drejt të kundërtës: drejt kuptimit të saktë, dijes së drejtë dhe urtësisë së thellë.

Feja e humb shpirtin e saj kur reduktohet në forma. Ajo merr jetë kur kuptohet si filozofi e jetës, që formëson zemrën e njeriut dhe harmonizohet me realitetin e tij, pa humbur parimet hyjnore, morale dhe njerëzore.

ISLAMI DHE DIVERSITETI NJERËZOR



Po t'i hedhim një sy njerëzve do të shikojmë që të gjithë janë të ndryshëm nga njeri-tjetri. Nuk ka asnjë njeri në botë që të jetë i njëjtë me dikë tjetër, pavarësisht ngjashmërisë. Edhe njerëzit që janë binjakë, janë të ndryshëm nga njeri-tjetri, ndonëse kanë shumë ngjashmëri në tipare të jashtme. Ndërkaq, bota e tyre e brendshme është ndryshe, preferencat, shijet, veshjet etj. janë të ndryshme. Në të njëjtën mënyrë janë dhe popujt, kombet apo edhe fiset njerëzore.

Ky realitet shprehet edhe në ajetin e 13. të sures Huxhurat ku thuhet: **"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."** (Huxhurat 49:13). Ky ajet nga njëra anë dëshmon diversitetin ndërmjet njerëzve, por në të njëjtën kohë dëshmon se ky diversitet ka ndodhur me vullnetin e Zotit, në mënyrë që njerëzit të mos jetojnë si koloni, porse të njihen me njëri-tjetrin, pra të kenë një identitet. Brenda këtij diversiteti, një gjë që i bashkon njerëzit, është bashkësia ose organizimi i tyre në fise, popuj dhe kombe. Pra çdo popull, fis apo komb ka veçorinë e tij, por e rëndësishme është që këta të jenë të devotshëm, t'i besojnë Allah'ut. Për të qenë afër Allah'ut nuk është kusht që individi medoemos t'i përkasë ndonjë populli ose kombi, mjafton që ky njeri të besojë dhe të jetë i devotshëm.

Nga njëra anë ne dimë që Islami është një fe universale dhe ka zbritur për të gjitha fiset, kombet, popujt dhe kohët, mirëpo, Kur'an'i ka zbritur në një gjuhë, si edhe Profeti i përkiste një kombi, dhe kuptohet që kjo gjë është e pashmangshme nga pikëpamja ontologjike dhe sociologjike.

Siç dihet edhe arabët kishin kulturën, traditën dhe zakonet e tyre para ardhjes së Islamit si cdo popull tjetër. Me zbritjen e Kur'an'it, ato që binin ndesh me fenë, Profeti (a.s) i hoqi. Ato që nuk ishin të përshtatshme i formatoi që ti përshtateshin fesë. Ndërsa ato që nuk binin ndesh me fenë nuk i preku. Në kohën kur Profeti (a.s) ishte gjallë, Islami ishte i përhapur vetëm në gadishull dhe si komb ishin vetëm arabët. Mirëpo, pas vdekjes së Profetit (a.s) në kohen e halifeve, kufijtë e shtetit islam filluan të zgjeroheshin dhe njerëzit me përkatësi të ndryshme etnike,

kulturore dhe fetare, filluan të pranojnë Islamin.

Lind pyetja: Islami si fe, animë do të ishte një standard në të gjithë fushat e jetës, apo vetëm në atë fetare? Ose e thënë ndryshe, të gjithë ishin të detyruar të vishnin veshjet e arabëve dhe të përdornin devetë, apo mjaftonte që ata të përthithnin vetëm besimin, ndërsa për të parën nuk ishin të detyruar? Po ti hedhim një sy historisë islame dhe përhapjes së Islamit nëpër vende dhe kombe të ndryshme, do të shohim që ka ndodhur e dyta. Pra, kur Islami u përhap në këto vende të cilat ishin të ndryshme nga arabët, ato përvetësuan besimin. Kultura, tradita dhe zakonet që nuk binin ndesh me fenë, u lejuan, ndërsa ato që binin ndesh me Islamin, u ndaluan ose u islamizuan. Kjo bëri që nga njëra anë, këta njerëz ta kishin më të lehtë ta pranonin Islamin dhe ta jetonin atë, dhe nga ana tjetër, bëri që qytetërimi islam të pasurohej edhe më tepër me kontributin e këtyre popujve. Kjo bëri që në botën islame të formoheshin disa tipologji kulturash, ku në vija të trasha ato kultura janë: ajo Arabe, Turke, Iraniane, e Afrikës së Zezë dhe Lindjes së Largët. Veçoria e tyre qëndron në faktin se të gjitha këto vende kanë etni, kulture, gjuhe dhe besime të ndryshme. Kur u bënë myslimane, këta popuj e komentuan Islamin sipas vendit dhe kushteve ku ata jetonin. Kjo pra, bëri që të shfaqen disa oaze kulturore në veçori të ndryshme nga njëra-tjetra. Po ti hedhim një sy vendit tonë, do të shikojmë që ai është më afër me tipologjinë kulturore turke, për shkaqe historike dhe sociologjike që tashmë dihen.

Ky diversitet që mund të vërehet në botën islamike, nuk është diçka e keqe apo negative. Përkundrazi, kjo gjë është parë si diçka pozitive dhe e natyrshme. Krahas kësaj, ky fakt reflekton njëherazi edhe në universalitetin e Kur'an'it dhe Islamit. Ajo që quhet islam ose islame në botë është sinteza e kulturës, traditës dhe zakoneve të një vendi në bazë të parimeve të fesë. Çdo vend ka veçoritë e tij në fushën e interpretimit të Islamit. Në këtë pikë, kjo është një nga çështjet që njerëzit keqkuptojnë më tepër. Kur njerëzit shkojnë në një vend islamik dhe vërejnë se si është bërë interpretimi i fesë atje, kur kthehen, ata ose binden se nuk ka interpretime të tjera, ose përfundojnë duke thënë se atje në atë vend është bërë një interpretim i gabuar.

Siç dihet, Kur'an'i ka zbritur me njeriun, për njeriun, me gjithë njeriun. Duke qenë se njeriu është një qenie sociale dhe jeton në kushte të ndryshme gjeografike, klimaterike, etnike, kulturore dhe fetare, edhe interpretimi i fesë dhe jetesa e saj do të jetë ndryshe. Ky ndryshim nuk është tek parimet fetare, por te jetesa e saj. Me jetesën fetare duhet të kemi parasysh veshjet, mikpritjen, marrëdhëniet sociale, martesat, festat, arkitektura etj. Ndërsa çështjet fetare që kanë të bëjnë me besimin dhe adhurimet në çdo vend janë njëlloj. Domethënë, askush nga myslimanët nuk vë në dyshim që kushtet e Islamit janë pesë dhe që agjërimi mbahet në Ramazan. Këto pra, e bëjnë Islamin universal dhe të pranueshëm. Përndryshe, nëse Islami do të ishte vetëm një stereotip, nuk do të kishte kuptim që të quhej universal. Mjafton që myslimanët t'i përmbahen hallallit dhe haramit, kushteve të besimit dhe adhurimeve. Ndërsa çështjet e tjera ndryshojnë sipas vendit, kohës dhe kushteve të jetesës. Pikërisht, për këtë arsye, nuk duhet akuzuar askush se nuk e jeton fenë ashtu siç duhet, sepse çdo botëkuptim është një interpretim më vete, dhe interpretimi nuk mund të jetë universal, por bazat e themeleve në Kur'an dhe Syne, janë. Pra, çdo interpretim i bërë duke ju përmbajtur metodologjisë Islame të nxjerrjes së interpretimeve gjithmonë ka qenë i pranuar nga dijetarët dhe besimtarët e këtij Umeti. Shembulli më konkret është ekzistenca dhe toleranca midis katër medh'hebeve të jurisprudencës Islame. Këto fakte kanë bërë që Islami, si fe që pranon realitetin njerëzor, të jetë e jetueshme që prej 1400 vjetësh dhe do të vazhdojë të jetojë edhe në të ardhmen.



NJË LUTJE NGA UVEJS EL'KARANI



O Zot! Kur një njeri troket në derën e një pallati të madh dhe ajo nuk i hapet atij, ai troket dhe thërret me zërin e dikujt i cili është i pranuar dhe i njohur tek pallati, me qëllim që ajo t'i hapet. Dhe kështu unë i mjeri, trokas në derën e Mëshirës Tënde duke thirrur me një zë të robit tënd të dashur tek Ti , Uvejs el'Karanit dhe me lutjen e tij. Hape atë derë me mëshirën Tënde edhe për mua, ashtu siç e hape për atë. Dhe të lutem me përgjërmin e tij:

أَقُولُ كَمَا قَالَ

إِلَهِي أَنْتَ رَبِّي وَأَنَا الْعَبْدُ , وَأَنْتَ الْخَالِقُ وَأَنَا الْمَخْلُوقُ
وَأَنْتَ الرَّزَّاقُ وَأَنَا الْمَرْزُوقُ , وَأَنْتَ الْمَالِكُ وَأَنَا الْمَمْلُوكُ
وَأَنْتَ الْعَزِيزُ وَأَنَا الدَّلِيلُ , وَأَنْتَ الْغَنِيُّ وَأَنَا الْفَقِيرُ
وَأَنْتَ الْحَيُّ وَأَنَا الْمَيِّتُ , وَأَنْتَ الْبَاقِي وَأَنَا الْفَاقِي
وَأَنْتَ الْكَرِيمُ وَأَنَا اللَّئِيمُ , وَأَنْتَ الْمُحْسِنُ وَأَنَا الْمُسِيءُ
وَأَنْتَ الْعَفُورُ وَأَنَا الْمُنْدَبُ , وَأَنْتَ الْعَظِيمُ وَأَنَا الْحَقِيرُ
وَأَنْتَ الْقَوِيُّ وَأَنَا الضَّعِيفُ , وَأَنْتَ الْمُعْطَى وَأَنَا السَّائِلُ
وَأَنْتَ الْأَمِينُ وَأَنَا الْخَائِفُ , وَأَنْتَ الْجَوَادُ وَأَنَا الْمُسْكِينُ
وَأَنْتَ الْمُجِيبُ وَأَنَا الدَّاعِي , وَأَنْتَ الشَّافِي وَأَنَا الْمَرِيضُ

فَاعْفِرْ لِي ذُنُوبِي وَتَجَاوَزْ عَنِّي وَاشْفِ أَمْرَاضِي يَا اللَّهُ يَا
كَافِي , يَا رَبِّ يَا وَافِي , يَا رَحِيمُ يَا شَافِي , يَا كَرِيمُ يَا مُعَافِي ,
فَاعْفُ عَنِّي مِنْ كُلِّ ذَنْبٍ وَ عَافِنِي مِنْ كُلِّ دَاءٍ وَأَرْضْ عَنِّي أَبَدًا
بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ
وَ آخِرُ دَعْوَاهُمْ أَنْ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

O Zot! Ti je Mbështetësi im, dhe unë jam vetëm rob.

Ti je Krijuesi, unë jam krijesa.

Ti je Furnizuesi, unë jam në nevojë për furnizim.

Ti je Pronari, unë jam i pronësuar.

Ti je Madhështori, unë jam i ulëti.

Ti je i Pasuri, unë jam i varfëri.

Ti je i Gjalli, unë jam i vdekuri.

Ti je i Përhershmi, unë jam i përkohshmi.

Ti je Mirëbërësi, unë jam keqbërësi.

Ti je Gjithëbujari, unë jam i ulëti.

Ti je Fajfjalësi, unë jam mëkatari.

Ti je Madhështori, unë jam i përçmuari.

Ti je i Gjithëfuqishmi, unë jam i dobëti.

Ti je Dhënësi, unë jam lypësi.

Ti je i Besuari, unë jam i frikësuar.

Ti je Bujari, unë jam i vobekti.

Ti je Përgjigjësi i lutjes, unë jam lutësi.

Ti je Shëruesi, unë jam i sëmuri.

Prandaj m'i fal gjynahet dhe m'i shëro sëmundjet, o Zoti im!

O i Vetëmjaftueshëm! O Mbështetës! O Besëplotë! O Mëshirëplotë! O Shërues! O Gjithëbujar! O Fajfjalës! Falmi të gjitha gjynahet, më dhuro shërim prej sëmundjeve dhe ji i kënaqur me mua përjetë! Nëpërmjet Mëshirës Tënde, o më Mëshiruesi i Mëshiruesve! Dhe përfundimi i lutjes së tyre do të jetë: I Gjithë lavdërimi i takon Zotit, Krijuesit të të gjitha botëve.

Pëllumbat e shpellës

Ishtenjë pasdreke mjaft e xehtë. Dielli i shkretëtirës i ngjyente në alle kodërzat e rërës përreth. Mes kodërzave ndodhej një oaz. Rreth atij burimi të vogël uji kishin mbirë e radhitur një sërë drurësh hurme. Degët e tyre të ngarkuara me hurma vareshin gjer përdhë. Me ngjyrën e tyre të verdhë në të artë, veshulët e hurmave dukeshin shumë të shijshme. Mbi degët e njërit prej drurëve ndodhej një fole pëllumbash.

Pëllumbat prindër i kishin marrë të vegjlit nën krahë. Pak më parë kishin ngrënë të gjithë së bashku dhe tani po preheshin të ngopur. Ata po sodisnin diellin që pasqyrohej mbi ujë. Sytë e pëllumbit nënë, pëllumbeshës, ishin kredhur në largësi. Pëllumbi baba, i cili e vuri re, e pyeti bashkëshorten:

“Gu-gu, Pëllumbeshë! Prapë u krodhe në mendime! Ç’po mendon ashtu?”

“Eh”, tha ajo duke rënkuar thellë. “Ti e di se ç’po mendoj, ore burrrë! Gu-gu!”

Pëllumbi tundi kokën rëndë-rëndë.

“E di”, tha duke buzëqeshur, “si nuk e di? Po mendon sërish për ato ditë të bukura, prapë!”

“Asnjë çast s’më hiqen nga mendja. Me përfytyrimin e tyre jetoj! Gu-gu!”

Të vegjlit e tyre, Hirushi dhe Larushi kishin vetëm ca ditë që kishin dalë nga veza. Ata s’dinin gjë për të kaluarën e prindërve të tyre. Ata u bënë shumë kureshtarë nga biseda e prindërve. Megjithëse kishin vetëm pak ditë që kishin ardhur në jetë, ata e kishin kuptuar se prindërit e tyre kishin një vend të veçantë mes zogjve dhe shpendëve të tjerë të atyre anëve.

Një ditë më parë, sorkadhet që kishin zbritur në breg të oazit, seç bisedonin dhe bënin me shenjë nga çerdhja e tyre. Kurse shqiponja që po fluturonte në kupë të qiellit, në çdo rrotullim, u thoshte: “Ju lumtë! Ju lumtë!”

Shkurt, të gjitha kafshët i përsëhendesnin dhe përpigeshin me sa kishin mundësi të mos i ngacmonte gjë.

Hirushi dhe Larushi nuk e kuptonin pse kafshët e tjera i vlerësonin kaq shumë. Një ditë menduan se kishte ardhur koha t’i pyesnin.

Me zërin e tij të hollë, Hirushi e pyeti t’ëmën:



"Mami, të lutem, më thuaj pse na duan kaq shumë kafshët, pse hiqen menjëherë mënjatë kur shkojmë për të pirë ujë dhe pse na përshëndesin me aq respekt?"

Nëna e mori sërish nën krahë me dashuri të voglin e saj, ia përkëdheli kokën me dhembshuri dhe iu drejtua me buzëqeshje të shoqit:

"Më duket se erdhi koha t'ua tregojmë çdo gjë fëmijëve! Ç' thua ti?"

"Po, këta u rritën aq sa të kuptojnë, pra, le t'ua tregojmë!"

Nëna e mori nën krahë edhe Larushin dhe nisi të tregojë:

"Ah, more bij, le të flasim më parë pak për Zotin. Si çdo gjë tjetër, edhe neve, Ai na ka krijuar. Ne jemi krijesat e Tij. Çdo ditë Ai na e siguron ushqimin, kurse ne e gjejmë, e marrim dhe e hamë. Ai lëshon nga retë në qiell shi, kurse ne e pimë."

"Pa shihni, more fëmijë", tha babai, "sa krahë të bukur e plot pendë ngjyranjyra na ka dhënë Zoti! Ne hapim krahët e fluturojmë në qiellin blu, kurse me sqepin gjejmë ushqim dhe

pastrojmë pendët. Pastaj..."

"O, babi... ", thirri Larushi, "unë sot i pastrova pendët, por sqepi nuk më arriti gjer te koka. Ç' duhet të bëj?"

"Bashkë me vëllanë, mund t'ia pastroni kokën njëri-tjetrit. Ndihma për njëri-tjetrin është gjë e mirë!"

Nëna e qortoi Larushin butë:

"I vogli im! Nuk duhet t'ia presësh fjalën babait! Duhet ta presësh të mbarojë, pastaj ta pyesësh. Kështu është më mirë!"

"Mirë, nënë", tha Larushi i bindur.

Babai vazhdoi:

"Sado ta falënderojmë Zotin tonë, është pak. Ai na do shumë. Edhe ne e duam shumë Atë!"

Larushi tha:

"Babi, ti flet shumë bukur. Por akoma nuk na ke treguar se pse kafshët e tjera na vlerësojnë kaq shumë. A s'u ka dhënë Zoti edhe atyre të mira si ne?"

Pëllumbi baba iu përgjigj duke buzëqeshur:

"Gu-gu! Bëj durim, vogëlush! Mësimi kërkon durim. Do t'ju tregoj! Unë dhe nëna juaj, veç të mirave që marrin të

gjitha kafshët nga Zoti, kemi marrë edhe një të mirë tjetër."

Pëllumbesha nuk duroi dot më. Me lotë lumturie në sy, tha:

"Edhe sikur të më jepej mundësia të jetoja miliona vjet në pyje të mbushur me gjelbërim, nuk do ta kisha ndërruar me ato ditë! Zoti ynë na fali një mirësi të madhe!"

Duke kërcyer me padurim nga vendi, Larushi e pyeti nënën:

"Mami, po ç'ndodhi, pra, ato ditë?"

"Pamë Profetin, o bir!.."

Pëllumbi dhe Pëllumbesha ishin prekur thellë nga kujtimet. Ata qanin me shpirt. Pas pak u qetësuan dhe Pëllumbi vazhdoi të tregojë.

"Nuk e harroj kurrë. Ishte vite më parë. Unë dhe nëna juaj ishim ende shumë të rinj. Ishte përsëri një ditë e nxehtë si kjo. Ne po fluturonim mbi kodrat e rërës. Ndërkaq, nga Zoti na erdhi një urdhër. Ne duhet të bënim një fole mu në hyrje të shpellës së quajtur Thevr. Me ta marrë urdhrin, përplasëm krahët me tërë fuqinë dhe fluturuam për në shpellë. Pa pushuar, në hyrje të saj ndërtoam fole."

Nëna u ngashërye sërish dhe tha:

"Gu-gu! Mu atëherë dëgjuam zëra nga brenda. Kthyem kokën, por ç'të shihnim? Brenda ishin i Dërguari i Zotit, profeti Muhamed, dhe shoku i tij, Ebu Bekri. Atë çast m'u duk se do të më ndalej zemra nga ngazëllimi!"

Larushi pyeti me kërshtëri:

"Mirë, moj mami, po si e njohët Profetin ju?"

Nëna qeshi.

"Vogëlushi im! Atë e njohin të gjitha gjallesat, madje edhe jogjallesat. Ai i thërret pemët dhe ato i shkulin rrënjët e i shkojnë pranë. Merr gurë në dorë dhe gurët fillojnë e luten për të. Retë i bëjnë hije. Ai ka një bukuri të tillë në fytyrë që, sapo ta shohësh, dashurohesh pas saj. Ai është i Dërguari i Zotit. Ashtu siç kanë bërë edhe profetët e tjerë, ai na e bën të njohur Zotin e na flet për Të. Ai u tregon njerëzve për të gjitha cilësitë dhe shprehitë e moralit të bukur. Në sajë të mësimëve të tij, myslimanët,

me të na parë neve, mendojnë për ne, për krijimin tonë. Ata kurrë nuk na bëjnë ndonjë të keqe, por na mbrojnë. A e mban mend se ç'ndodhi dje kur re nga foleja? Të gjithë ne po bërtisnim nga tmërri, kur ty të dalloi një mysliman që në atë kohë po i jepte devesë ujë. Ai u afrua, të mori në duar me përkëdheli, tha "sa të bukur e ka bërë Zoti", të puti dhe të vuri në fole pa të shkaktuar asnjë dëm. Duke të vënë, tha "bismil'lah". Sa u gëzuam ne për këtë sjellje, apo jo!"

"Po, nënë", tha ai. "Ai xhaxhi u soll shumë mirë me mua. Dhe këtë ia paska mësuar profeti Muhamed! Unë tani do ta dua më shumë atë!"

Pëllumbi baba vazhdoi:

"Por sa keq që ka nga ata që nuk ia dëgjojnë fjalën atij! Ata na quajnë ne qenie të pavlera, që ekzistojmë pa ndonjë qëllim, nuk u vjen keq për ne, prandaj edhe na shajnë dhe na bëjnë keq!"

"Ja, pra, të vegjlit e mi", tha nëna, "atë ditë, Profeti me Ebu Bekrin ndodheshin në shpellë. Ata po mërgonin, po largoheshin nga Meka për në Medinë."

Duke i hapur sytë me kërshtëri, Larushi pyeti:

"Po pse i linin shtëpitë e iknin?"

"Kushërinjtë tanë të Mekës na treguan se ç'kishte ndodhur. Idhujtarët kurejshë të Mekës u bënë shumë të këqija myslimanëve. Ata përpiqeshin t'i detyronin myslimanët të hiqnin dorë nga besimi islam. Prandaj myslimanët, me leje të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kishin filluar të largoheshin për në Medinë."

"Ky largimi quhet hixhret. Idhujtarët dashkan ta pengojnë edhe hixhretin e myslimanëve!"

"Po pse idhujtarët s'duan që myslimanët të mërgojnë? A na thatë se nuk i duan myslimanët e u bëjnë shumë të këqija?"

"Sepse idhujtarët paskan frikë nga bashkimi i myslimanëve me medinasit dhe fuqizimi i tyre! Ata shqetësohen se mos një ditë Profeti Muhamed vihet në krye të tyre dhe i sulmon. Idhujtarët paskan bërë një mbledhje ku, me

propozimin e Ebu Xhehlit, paskan vendosur ta vrasin Profetin. Pastaj, një natë, e paskan rrethuar shtëpinë e tij, por Allahu e paska njoftuar. Profeti paska vënë Aliun në shtratin e vet dhe paska dalë nga shtëpia duke kaluar para syve të tyre!"

"Pa e parë ata?"

"Pa e parë, vogëlushi im, sepse, kur Allahu s'do, askush nuk mundet të shohë. Dhe, kështu, pasi kishin pritur gjithë natën rreth shtëpisë së Profetit, idhujtarët ishin habitur kur kishin parë Aliun të dilte që atje!"

Nëna mori pak frymë dhe vazhdoi:

"Ndërkaq, Allahu e kishte urdhëruar të Dërguarin e Tij të mërgojë. Ai u mor vesh me Ebu Bekrin dhe u nisën. Shkuan në fillim në shpellën Theur ku u fshehën. Ja, pra, atëherë ne e bëmë folenë tonë mu në hyrje të shpellës që ishte si një vrimë e madhe. Një motra jonë merimangë thuri një rrjetë të madhe me të cilën e zu tërë hyrjen e shpellës. Gjatë kësaj kohe, idhujtarët ishin vënë pas Profetit dhe Ebu Bekrit."

Larushi i kishte mbetur sqepi hapur nga habia.

"Kështu, ë?", tha ai me habi. "Dy pëllumba dhe një merimangë kundër gjithë atyre burrave të armatosur!"

"Mirë, po ç'ndodhi atje, moj nënë?", pyeti Hiroshi duke përplasur krahët e vegjël.

Nëna iu përgjigj:

"Idhujtarët i qenë afruar shumë shpellës. Ebu Bekri ishte shqetësuar. Ai kishte frikë se mos idhujtarët i bënë ndonjë të keqe Profetit. 'O i Dërguari i Allahut', i kishte thënë ai Profetit, 's'më vjen keq po të më vrasin mua, por, mos e dhëntë Zoti, po të të bëjnë keq ty, kjo gjë do të sillte shkatërrimin e të gjithë bashkësisë së myslimanëve! Kurse Profeti ishte i qetë. Ai u përpoq ta qetësonte Ebu Bekrin duke i thënë: 'Mos u dëshpëro, Allahu është me ne!'. Por ai i tha: 'O i Dërguari i Allahut, po qe se ndonjëri prej tyre përkulet dhe sheh brenda në shpellë, na dallon nga këmbët që jemi këtu! I sigurt në vetvete, Profeti u përpoq sërish për ta qetësuar

Ebu Bekrin duke i thënë: 'O Ebu Bekr! Mos u mërzit e mos u shqetëso se Allahu është me ne! Pastaj bëri lutje që Allahu ta qetësonte atë!

Idhujtarët e kishin parë folenë tonë dhe rrjetën e merimangës dhe, duke menduar se aty s'do të kishte njerëz, ishin larguar."

Duke i shkëlqyer sytë, Larushi pyeti:

"Mirë, moj nënë, po sa ndenjën ata në shpellë?"

"Tri ditë e tri net, vogëlushi im! Pastaj atje shkoi një prijës me dy kuaj dhe ata u larguan."

Pëllumbi baba i pa fëmijët në sy me kujdes dhe u tha:

"Ja, kështu, vogëlushët e mi! Unë me nënën tuaj kurrë s'kemi për t'i harruar ato tri ditë të bukura! Ne jemi shumë të lumtur që e pamë Profetin, e shoqëruam dhe bëmë roje për të!"

Larushi tha tërë mërzitje:

"Mirë, po ne nuk e pamë dot!"

"Ashtu është, por edhe ju, po të bëni siç na këshillon ai, edhe do të fitoni pëlqimin e Allahut, edhe do ta shihni atë në xhenet."

Nëna pëllumbeshë tha:

"Ka vite që njerëzit na përmendin ne duke na treguar si shembull se, me anë të qenieve të dobëta, Allahu mund t'i shkatërrojë edhe ata që duken si shumë të fuqishëm!"

Pëllumbi baba shtoi:

"Vogëlushët e mi, ne presim nga ju që të jetoni sipas urdhrave që Allahu, Zoti ynë, na i ka bërë të ditura me anë të të Dërguarit të Tij, Profetit Muhamed. Kështu, jeta juaj kthehet në xhenet dhe fitoni kënaqësinë e Allahut dhe të Profetit!"

Në folenë e pëllumbave majë degëve të një druri hurme, mori fund një bisedë e ëmbël. Me përfundimin e diellit, qielli u mbush plot yje. Nën vezullimin e yjeve të shkretëtirës, pëllumbat u përqaftuan me njëri-tjetrin dhe ranë në një gjumë të lumtur.

Në ëndërr, Profeti u buzëqeshte, i merrte në dorë dhe i përkëdhelte me dashuri.

*Ç'do të bëhet,
vallë, halli im!*

Më ra një frikë në shpirt: ç'do të bëhet, vallë, halli im?
Po të mos gjej derman, ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Shpirti do të përgatitet me hidhërim të ikë nga trupi,
Kjo trajtë do të priset; ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Kur rrobat të më hiqen, trupi të më ngrijë,
Kur të më shtien në varr, ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Të tjerët do të ikin, unë do të mbetem, i vetëm në varr;
Munker e Nekir do të vijnë, ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Këmbë e duar ngrirë, as mend në kokë, as gjë në mend;
Gjuha s'do të përgjigjet dot; ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Nga varri do të ngrihem, peshorja e drejtësisë do të vihet,
Bëmat do të na gjykohen; ç'do të bëhet, vallë, halli im?

Junusi i varfër flet me sytë të përbotur, të përskuqur,
Sheh kthinën e vet dhe mendon: ç'do të bëhet, vallë, halli im?




APLIKACIONI ZYRTAR I KMSH-së

- Kohët e namazit
- Drejtimi i Kiblës
- Xhamia më e afërt
- Pyetje-përgjigje
- Kuran
- Njoftime



APP STORE



Skano kodin për të shkarkuar aplikacionin në IOS



PLAY STORE



Skano kodin për të shkarkuar aplikacionin në Android

WWW.KMSH.AL

